

GEORG BOVT

Kush do ta
fitoje Luften e
re te Ftohte?



Nation

Profecia e
fundit e
Kissingerit




FAREED ZAKARIA

A eshte
racional
Irani?

Politika

Botim elektronik i ASP ne bashkepunim me Bota.al Prill 2013



PERPLASJA E MADHE NE LINDJEN E MESME, SHITE E SUNNITE

Rikthim tek Loja e Madhe



Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Botim elektronik i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me Bota.al

bota.al

Friday, June 20, 2014

HOME BOTA EKONOMI TEKNOLOGJI HISTORI SHKENCE KULTURE DOSSIER SPORT

INTERVISTA/Habermas: Propozimi im për një Union më demokratik

Jürgen Habermas është sociolog dhe filozof gjerman, i traditës së teorisë kritike dhe pragmatizmit. Ai është bërë i njohur për teoritë e tij të racionalitetit të komunikimit dhe sferës publike. Sipas sondazheve globale, Habermasi pranohet gjerësisht si një prej...

June 19, 2014

BOTIMESHQIP.COM

Në Shqipëri ju i merrni librat brenda 24 orëve dhe i paguani lehtë në dorë kur merrni librat.

Në çdo vend tjetër të botës ju i merrni librat brenda pak ditësh dhe mund të paguani me PayPal, transferë bankare, etj.

botimeshqip.com
Libri Shqip në shqipëri tani!

Kontaktet:
Akademia e Studimeve Politike
Adresa:
Qendra Kotoni,
Rr.Donika Kastrioti,
Nr.3,
Kati 4, Zyra 2,
Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 227 2173,
Tel: +355 4 450 4788
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al
dhe www.bota.al

Përzgjedhja, redaktimi dhe përkthimi i materialeve në këtë buletin kryhet nga alumni i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, z. Ermal Gjinaj



PER POLITIKEN:

Për mua, është e domosdoshme të krijoj një imazh fituesi, kështu që, më duhet të mund dikë...

Richard Nixon

Një prej penalteteve për mospërfshirjen në politikë, është se përfundon të qeverisesh nga njerëz që janë inferiorë

Platoni

Vendet më të errët të Ferrit u janë rezervuar atyre që ruajnë neutralitetin në kohë krize


Dante Aligieri

Politika është lufta pa gjakderdhje, ndërsa lufta është politikë me gjakderdhje

Mao Cedun

Politikanët e këqinj dërgohen të qeverisin, prej njerëzve të mirë që nuk votojnë

William E. Simon



Letër për miqtë e mi rusë

NGA ROBERT E. BERLS JR.

Rusia ka qenë gjithmonë e ndryshme, për shkak të historisë së saj unike dhe problemeve të saj, që e veconin atë prej fqinjëve. Ajo që mund të ketë qenë e mundur në shtetet balltike dhe Poloni, nuk duhej të vihej asnjëherë në zbatim edhe në Rusi. Në vitet 1990 dhe 2000, a mos isha unë fajtor që u rrëmbeva prej euforisë që rriti pritshmëritë në Perëndim, si dhe mes segmenteve të popullsisë ruse se Rusia, më në fund, i kishte hyrë rrugës së ndryshimeve rrënjësore? Po, isha fajtor. Të dashur miq,

Ka kaluar më shumë se një vit nga udhëtimi im i fundit në Moskë. Gjatë kësaj kohe, shumë gjëra kanë ndryshuar në drejtimin ku presidenti Vladimir Putin po e udhëheq Rusinë. Ndihem shumë ndryshe kundrejt Ruisë sot. Më lejoni të shpjegojem.

Rusia ka qenë një pjesë qendrore e jetës sime akademike dhe profesionale. Si student, kam mësuar për gjithcka ruse dhe më pas ia kam kushtuar karrierën time përpjekjeve për të kuptuar Rusinë dhe popullin rus. Doja të kontribuoja për përmirësimin e marrëdhënieve mes Ruisë dhe Shteteve të Bashkuara. Gjatë gjithë karrierës sime, kam qenë i vetëdijshëm për gjërat tona të përbashkëta, por edhe

për sfidat shumë të mëdha me të cilat përballemi, në kapërcimin e paragjykimeve që kemi për njëri-tjetrin.

Me kalimin e viteve, kam mbetur optimist se arsyeja e shëndoshë do të mbi-zotëronte, sa kohë që ishim të ndershëm me vetveten dhe me njëri-tjetrin. Tani, për herë të parë pas shumë dekadash, kam seriozisht dyshime nëse ai optimizëm është i justifikuar.

Jam thëllësisht i shqetësuar se Rusia po rrëshket sërish në një formë autoritarizmi ku interesat e pakicës po ndiqen, në dëm të atyre të shumicës. Qeveria që shohi i bën të heshtin kundërshtarët, kërkon kontroll total të mas medias, nxit shtrembërime të fortë të të vërtetës dhe e paraqet botën e jashtme si armiqësore.

Dua që ju të kuptoni se zhgënjimi im nuk është se Rusia dështoi të përmbushë pritshmëritë dhe standartet perëndimore, të cilat shumëkush supozoi se Rusia do i adoptonte pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik.

Rusia ka qenë gjithmonë e ndryshme, për shkak të historisë së saj unike dhe problemeve të saj, që e veconin atë prej fqinjëve. Ajo që mund të ketë qenë e mundur në shtetet balltike dhe Poloni, nuk duhej të vihej asnjëherë në zbatim edhe në Rusi. Në vitet 1990 dhe 2000, a mos isha unë fajtor që u rrëmbeva prej euforisë që rriti pritshmëritë në Perëndim, si dhe mes segmenteve të popullsisë ruse se Rusia, më në fund, i kishte hyrë rrugës së ndryshimeve rrënjësore? Po, isha fajtor. Megjithatë, me kalimin e kohës kuptova se shumë prej bashkatdhetarëve të mi po përpiqeshin të krijonin një realitet në rusi i cili ishte, në rastin më të mirë një iluzion, dhe të rastin më të keq gënjeshtar dhe i dëmshëm. Dhe rusët që kërkonin të kishin qasje në gjithcka që u ishte privuar gjatë viteve sovjetike, si dhe shansin për të nisur një jetë të re e të lirë, kuptuan se Perëndimi po u bënte disa premtime që ai nuk mund t'i mbante.

Është e qartë se të gjithë kanë faj për gjendjen e marrëdhënies sot. Për të ecur përpara, vetëm dialogu i hapur dhe i sqartë, në të gjithë nivelet mund të na ofrojë një mundësi për të frenuar spiralen në rënie të marrëdhënies së Ruisë me Perëndimin.

Fatkeqësisht, nuk jam optimist se kjo është koha e duhur për angazhim efikas. Rusia ka hyrë në një fazë vecanërisht të rrezikshme të historisë së saj. Stabiliteti që kish qenë një tipar dallues i viteve të parë të epokës së Putinit, tani është seriozisht në dyshim. Pothuajse të gjithë treguesit ekonomikë kanë marrë për poshtë.

Edhe më e rëndësishme është se politika e Putinit në Ukrainë, armiqësia e tij kundrejt Perëndimit dhe sanksionet që rezultojnë mund të kenë një impakt negativ në rrethin e tij të ngushtë. Këta veprimet mund të vënë në rrezik stabilitetin e regjimit, duke krijuar një dinamikë shumë të rrezikshme dhe të dëmshme në Rusi dhe përtej.

Nuk është shumë vonë që Rusia të ndryshojë drejtim nga kursi aktual. Shpresoj që do të vijë një ditë kur populli rus do të jetojë në një vend ku zëri i tij të dëgjohet dhe ndjekja e interesave të tij të jetë shqetësimi kryesor për qeverinë e tij. Shpresoj të vijë një ditë kur optimizmi që ka mbizotëruar përgjatë gjithë jetës sime të rikthehet, dhe unë të ndihem edhe një herë i frymëzuar dhe shpresëplotë për të ardhmen e Ruisë.

Sinqerisht,

Bob

Robert E. Berls Jr. ka një Ph. D për Studime mbi Rusinë nga Universiteti i Georgetownit. Ai është një oficer karriere në Forcat Ajrore të SHBA dhe ka qenë atashe në ambasadën e SHBA në Moskë nga viti 1985 deri në vitin 1988. Aktualisht, është këshilltar i lartë për Rusinë dhe Eurazinë në Nismën mbi Rrezikun Bërthamor në Uashington.



Nga Rusia, me shqetësim: Përgjigje një miku amerikan

IVAN TIMOFEEV

Letër-përgjigje e hapur nga Ivan Timofeev, Drejtor Programesh në Këshillin Rus të Cështjeve Ndërkombëtare, drejtuar homologut të tij amerikan, Robert E. Berls Jr.

I dashur Bob,

Faleminderit për letrën tënde të sinqertë dhe miqësore. Kolegët e mi dhe unë e kemi vlerësuar gjithmonë mendimin tënd si një oficer, akademik dhe diplomat me përvojë. Vec kësaj, unë e di fare mirë që ti asnjëherë nuk i shtrembëron fjalët, dhe nuk shpreh kollaj opinione. Nëse një person me staturën tënde profesionale bën një deklaratë, ajo kërkon vëmendje të madhe. Jam dakord se rrjeta e problemeve kërkon një debat gjithëpërfshirës. Kjo letër është përgjigja ime ndaj propozimit tënd për dialog.

E kuptoj pesimizmin tënd në lidhje me gjendjen e marrëdhënieve SHBA-Rusi. Më beso, situata nuk është më pak alarmante në Moskë, se sa është në Uashington. Për më tepër, nervozizmi do të ishte edhe më akut, nëse problemi do të ishte i kufizuar vetëm tek Ukraina. Kam frikë se problemi është më i gjerë në shtrirje. Ngjarjet në Ukrainë dhe përkeqësimi i madh i marrëdhënieve tona janë vetëm një

simptomë e një sëmundjeje më të thellë. Nuk është as e para, as e vetmja. Arsyet janë më të thella, dhe pasojat e tyre mund të jenë katastrofike.

Në fundin e Luftës së Ftohtë, SHBA iu paraqit një shans unik për të udhëhequr komunitetin ndërkombëtar. Idealisht, bëhej fjalë për rolin e Amerikës si e parë mes të barabartëve në botën e re shumëpolare. Për të udhëhequr përmes shembullit, jo forcës. Një udhëheqje e tillë bartte përgjegjësi të madhe, sigurisht. Bota po bëhej më e ndërlikuar dhe më pak e prirur për zgjidhje “shablone” për të gjithë. Udhëheqja në këtë botë shumëpolëshe kërkonte burime të mëdha, ekspertizë diplomatike dhe risi në manovrimet. Dhe të mos harrojmë gjënë më të rëndësishme: një udhëheqje e tillë kërkonte veprime të përbashkët dhe bashkëpunim të efektshëm. Përgjegjësia kërkohet të ndarë me qendrat e tjera të pushtetit, përfshirë Rusinë.

Për fat të keq, shansi për të udhëhequr “rrëshkiti mes gishtërinjve” dhe ne ngelëm në testin e bashkëpunimit. Vendet e mungesës së stabilitetit tashmë po shumëfishohen me çdo ditë që kalon. Pa arritur që të shihnim në Ukrainën Lindore një rreze të zbehtë shprese, ja ku ndodhi që Lindja e Mesme u përfshi edhe një herë nga një tjetër zjarr. Terrorizmi ndërkombëtar nuk është zhdukur. Cekuilibrat globalë po bëhen më të fortë. Dhe në këtë sfond, ne tregojmë muskujt, vazhdojmë me intrigat tona, kërcënojmë njëri-tjetrin me luftë, dhe me dëshirë i ushqejmë flakët që rriten.

Ka një rrezik të madh në dëmtimin pa kthim të stabilitetit strategjik. Jam thellësisht i shqetësuar për lidhjen e konflikteve tona lokale me marrëveshjet globale mbi raketat bërthamore. Ajo çështje ka mbetur gjithmonë mbi tryezë, pavarësisht se sa të shumtë apo kompleksë kanë qenë problemet e tjerë që na kanë dalë. Populli rus dhe ai amerikan e di mirë se nga kjo çështje varet fati i njerëzimit.

Por tani situata po ndryshon. Ligji i Mbështetjes së Lirisë së Ukrainës i kush-ton një paragraf të vecantë pajtueshmërisë me Traktatin e Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme. Sigurisht ne nuk e shohim njëri-tjetrin në sy, në lidhje me raketat me rreze të mesme dhe të vogël veprimi. Një ndryshim i tillë në opinione nuk është aspak gjë e re. Por ne kemi ruajtur gjithmonë një dialog të qetë dhe të arsyeshëm. Përse duhet që kjo çështje të lidhet me Ukrainën?

Po, kriza e Ukrainës është e tmerrshme. Pozicionet tanë ndryshojnë në parim, dhe kjo është temë që meriton një diskutim të vecantë. Por në kontekstin e marrëdhënieve tona, tema e raketave bërthamore qëndron në një rrafsh krejt tjetër. Duke lidhur dy çështjet ne vetëm do të dëmtojmë Traktatin e sipërpërmendur, duke e përmbysur ndërkohë stabilitetin strategjik. Ai është tashmë një i vdekur që ecën. A do të përmirësohet si rezultat i kësaj sigurie e SHBA, Ruisë dhe Europës? A përfiton gjë Ukraina? Jo. Dhe as nuk mund të shpresojmë për një traktat të ri në të ardhmen e afërt.

Raketat bërthamore janë vetëm një prej fushave të shumta ku bashkëpunimi ynë me dobi reciproke ka ngrirë. A e bën kjo botën më të qëndrueshme? A e ndal rrëshkitjen drejt anarshisë dhe kaosit? Sërish, përgjigja është jo.

Në këndvështrimin tim, detyrë prioritare është të minimizohet dëmi që kriza e Ukrainës ka shkaktuar mbi ato fusha të bashkëpunimit që janë jetike për ruajtjen e stabilitetit global. Përmes partneritetit në këto fusha ne mund të jemi në gjendje të rikthejmë të paktën një minimum besimi. Pa të, një hendek i pabashkueshëm do të krijohet mes nesh për çështjet më të vështira, përfshirë edhe Ukrainën. Një zgjidhje është që ta ndajmë dialogun tonë në “copa” të menaxhueshme, ku secila të ketë një çështje specifike. Sigurisht do të ketë mbivendosje, por nuk është kjo e rëndësishme. Të paktën do të shërbejë për të mos lejuar politizimin e tepruar të problemeve, gjë që po i dëmton vendet tona dhe botën.

Një tjetër gjë e rëndësishme: unë mendoj se është jetike të ndajmë debatin për axhendën politike të Ruisë, nga problemet e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Nevojitet një dialog i tillë. Po kështu nevojitet edhe një konsultim për ndryshimet që kanë ndodhur në politikën e brendshme të SHBA. Një “antipastë” e shijshme u ofrua pak kohë më parë nga Mikhail Gorbachevi, i cili bëri thirrje për një perestrojkë në Shtetet e Bashkuara.

Sigurisht, unë e kuptoj që për çështje të politikave, lidhja e të brendshmes me të jashtmen është pjesë e traditës liberale të Amerikës. Por edhe këtu, politizimi i tepruar po pengon kërkimin e kompromisit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në diskutimin tonë të problemeve ndërkombëtare, ne duhet të mbetemi realistë. Thënë kjo, sado që unë e njoh diturinë tënde mbi vendin tim dhe duke patur parasysh vëmendjen që ti i kushton, në letrën tënde, situatës në Rusi, shpresoj të prek një “kordë” që është në thelb ruse.

Amerikanët i kanë dhënë gjithmonë një kuptim thelbësor çështjes së demokracisë. Demokracia në vetvete perceptohet si një vlerë në Shtetet e Bashkuara.

Në Rusi, ne i respektojmë vlerat që amerikanët i kanë të shtrenjta. Vec kësaj, nuk ka gjasa që të gjesh në Rusi një shumicë të qëndrueshme që të kundërshtojë idenë e demokracisë dhe të mbrojë sundimin e rreptë autoritar.

Demokracia, sipas mendimit tim, duhet të menaxhohet si një mjet praktik. Ajo është një mjet për të përgatitur skenën kundër krizave politike. Cdo shtet ka nevojë për udhëheqës të talentuar dhe vizionarë. Por ka një kërkesë edhe më të fortë për institucione të efektshme. Aty qëndron vlera më e rëndësishme e demokracisë.

Megjithatë, një analizë e kthjellët kërkon që të merren në konsideratë disa pika kyce. Është e qartë që sistemi politik në Rusi po i nënshtrohet një transformimi të zgjatur. Në Francë, për shembull, një transformim i tillë kërkoi më shumë se 150 vjet që të ndodhte. Dhe nuk ishte një proces që shkoi “vaj”. Edhe në SHBA, demokracisë iu deshën pak kohë që të ngrihej në këmbë. Amerika kaloi një luftë civile të përgjakshme. Dhe kjo ndodhi në një kohë kur kushtet e jashtme ishin të favorshme!

Me sa duket, Rusia ka edhe disa udhëkryqe historikë për të kaluar. Dhe Zoti na ndihmoftë, që të mos kemi trazira të ngjashme historike. Rusëve do u duhet të armatosen me mencurinë, vetëpërmbytjen dhe forcën e mendjes, për të kryer reforma të matura dhe të qëndrueshme. Cdo revolucion apo përpjekje për të “ndërtuar një botë fringo të re” është i destinuar të dështojë.

Duhet mbajtur gjithashtu parasysh se Rusia kaloi nëpër një krizë shtetësie, jo shumë kohë më parë. Pasi kishte përfutur lirinë formale pas shembjes së Bashkimit Sovjetik, populli rus u bë dëshmitar i shpërbërjes së institucioneve, moralitetit, ligjit dhe rendit, bombardimit të parlamentit nga tanket, dhe manipulimeve masive elektorale në vitin 1996. Vetë shpërbërja e Bashkimit Sovjetik (e mbështetur në mënyrë të qartë prej Perëndimit) në thelb i ngjante një grushti shteti. A është për t’u habitur që strukturat politike që u ngritën pas kësaj ishin kaq kalimtare dhe të pasigurta?

Si Rusia, edhe Perëndimi, në fillim iu qasën hapësirës post-sovjetike si një zone të rrafshuar. Por historia lë një shenjë të pashlyeshme, e cila nuk mund të fshihet. Në një masë të madhe, kriza në Ukrainë është rezultat i gabimeve “në programim” të të shkuarës. Këta gabime bëhen edhe më kompleksë prej kaosit në rritje në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ata do të vazhdojnë të ndihen.

Detyra jonë e përbashkët, si profesionistë, është që t’i largohemi sa më shumë të jetë e mundur informacionit dhe propagandës. Anarshisë, kaosit, paragjykimeve dhe stereotipeve duhet t’u kundërvihemi me arsye, gjykim të kthjellët dhe vetëdijësim për interesat tona të përbashkëta. Situata është më komplekse se kurrë. Por vetë ky fakt do të tregojë aftësinë e SHBA dhe Rusesë për të mbetur aktorë kyçë dhe për të zgjidhur problemet specifike.

Sinqerisht,
Ivani



Kush do ta fitojë Luftën e re të Ftohtë?

NGA GEORGE BOVT

Duket se një Luftë e re e Ftohtë, midis Rusisë dhe Perëndimit është e pashmangshme, edhe nëse konflikti në Ukrainë mbetet i “ngrirë” në formën e tij aktuale, së paku deri këtë verë. Ishte e qartë që një vit më parë, me aneksimin e Krimesë dhe fillimin e luftës në Ukrainën Lindore, se marrëdhëniet e Rusisë me Evropën, dhe veçanërisht me Shtetet e Bashkuara, nuk do të mbeteshin si më parë.

Tani është koha të pyesim sesi do të duket kjo përballje e re, si ideologjikisht ashtu edhe institucionalisht. Format e ndërveprimit mes Rusisë dhe Perëndimit, që u zhvilluan pas Luftës së parë së Ftohtë, të tilla si Partneriteti për Paqe me NATO-n dhe partneriteti me Bashkimin Evropian, tanimë janë lënë në harresë. Dhe në qoftë se, për shembull, Rusia kthehet në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës deri në fund të vitit, ajo do të përballet atje me kritika të pafundme dhe leksione sesi duhet të sillen në shtet demokratik.

Dhe për shkak se këto organizata, janë të bazuara mbi parime të caktuara, anëtarësimi në to për Rusinë kishte kuptim, sa kohë që Moska ishte angazhuar në një dialog për “vlerat e përbashkëta evropiane”. Por tanimë që Kremli e ka bërë mëse të qartë se nuk ndan më këto vlera, përse të mërzhitet më kot duke lënë një tjetër hapësirë për sherr me Perëndimin? Anëtarësimi në Këshillin e Sigurimit të

OKB-së, i ofron mundësi të mjaftueshme për këtë.

Me bashkëpunimin, që tashmë është diçka e së shkuarës, çështja më e ngutshme është sesi ky ballafaqim do të marrë formë në nivel institucional. Gjithashtu, si mundet komuniteti ndërkombëtar të institucionalizojë procesin e “arbitrazhit”, për të zgjidhur ato çështje, që megjithëse të pakëndshme, të dyja palët duhet përfundimisht të përballen? Energjia, është aktualisht njëra prej tyre.

Tani për tani, BE-ja vazhdon të blejë gaz nga Rusia, edhe pse ka bërë tashmë një përparim të rëndësishëm në strategjinë e saj, për të minimizuar varësinë energjitime në Moskë. Vendimi i BE-së, për të krijuar një union të energjisë, është tashmë një hap drejt “përballjes institucionale”. Si fillim, bashkimi do të konsolidojë marrëdhëniet kontraktuale të shteteve anëtare të BE me Gazpromin, çka në mënyrë të paevitueshme, do të reduktojë të ardhurat e kompanisë ruse nga Evropa, në një kohë që po përjeton që tani humbje të mëdha, si pasojë e rënies së çmimeve të energjisë.

Ndërsa intrigat shtohen, në lidhje me përpjekjen e Rusisë për të anashkaluar Ukrainën nëpërmjet Turqisë, Përfundimi do të kundërpërgjigjet me furnizime alternative nga Azerbajxhani, Turkmenistani dhe Irani. Ndërkohë Rusia, ka gjasa të përjetojë kufizime të mprehta në qasjen e tubacionit “Opal” në Gjermani. Përfundimi do të reduktojë varësinë e tij ndaj gazit të lëngshëm, me qëllim pakësimin në masë të madhe, apo duke i dhënë fund krejtësisht varësinë e saj nga gazi rus, brenda dy ose tre viteve të ardhshme.

BE-ja gjithashtu është duke u përgatitur për një përballje informative dhe propagandistike me Rusinë. Ajo tashmë po përpiqet të krijojë një kontrapunkt informativ ndaj rrjetit televiziv “Russia Today”, por më në përgjithësi, një konfrontim në fushat humanitare dhe informative, do të ndryshojë shumë nga ajo e Luftës së Parë të Ftohtë. Evropa, nuk do ta paraqesë atë si një garë midis dy mënyrave të jetës, apo të dy vizioneve të ndryshme për të ardhmen, mbi të gjitha sepse Rusia duhet ende të formulojë vizionin e vet e të ardhmes për konsum të brendshëm, dhe të shpjegojë sesi ajo ndryshon nga Përfundimi. Por ndoshta edhe ky aksion, do të avullojë në një përpjekje banale, për të manipuluar opinionin publik.

Gara mes dy sistemeve sociale konkurruese ka përfunduar. Rusia e ka braktisur sistemin sovjetik të ndërtimit të një shoqërie më të drejtë, të lumturisë universale, barazisë dhe vëllazërisë. Edhe aleatët politikë të Moskës nuk janë më pjesë e “lëvizjes komuniste botërore”, por vetëm shtetet individuale ose partitë politike, si ajo e ekstremit të djathtë në Francë, Fronti Kombëtar i Marin Lë Pen.

Aleanca të tilla nuk janë sistematike, sikurse ishte Traktati i Varshavës, por individuale dhe kryesisht bazohen tek anti-globalizimi apo qëndrimi anti-SHBA, ose edhe euroskepticizmi. Nëse kryeministri hungarez Viktor Orban apo Partia Syriza në Greqi do të kishin humbur pushtetin, është e paqartë sesi këto vende do të përcaktonin marrëdhëniet e tyre me Moskën. Në përballjen aktuale, Përfundimi do të fokusohet në zbatimin e presionit ekonomik në Rusi, apo thënë më thjesht, në asfiksimin e regjimit të presidentit Vladimir Putin.

Thelbësore është se kushtet ekonomike sot ndryshojnë rrënjësisht nga ato të Luftës së Parë Ftohtë.

Edhe pse Bashkimi Sovjetik u dobësua në masë të madhe nga lufta, ai kishte një ekonomi të vetë-mjaftueshme, që mbështetej pak tek tregjet e huaja. Me çmobilizimin e viteve ‘50, “shkrirjen” e ish-kreut sovjetik Nikita Hrushovit, dhe përpjekjet për të filluar një “revolucion shkencor dhe teknologjik” në vitet ‘70, Bashkimi Sovjetik arriti madje të dëshmojë edhe aftësinë për të ndërtuar potencialin e tij industriale dhe teknologjik. Megjithatë, në fillim të Luftës së Dytë të Ftohtë, Rusia ka arritur në thelb të kundërtën: shkatërrimin e bazës së saj industriale, dhe akoma më keq, humbjen e nivelit të dikurshëm shkencor dhe teknologjik.

Ndërsa Bashkimi Sovjetik, mundi të thoshte fjalën e tij në “garën hapësinore” me Shtetet e Bashkuara në vitet ‘60, sot Rusia i merr shumë prej pajisjeve të saj

kryesore, duke përfshirë përbërësit thelbësorë për kompleksin e saj ushtarako-industrial, nga Perëndimi. Dhe kjo është pikërisht pika e dobët, ku Perëndimi do ta godasë.

Kohëzgjatja dhe zgjidhja përfundimtare e Luftës së Ftohtë aktuale, varet nga ajo sesi, apo nëse, Rusia do t'i përgjigjet kësaj sfide.

Nëse Moska nuk do të zgjidhë problemet e saj teknologjike dhe ekonomike, ajo mund të përjetojë jo vetëm shembjen e infrastrukturës së saj industriale e sociale, si dhe të degradojë në një shtet të dështuar brenda 15 viteve të ardhshme, por edhe të humbë potencialin e saj ushtarak për përballjen me Perëndimin. Ajo korvizë kohore është edhe kohëzgjatja maksimale për këtë Luftës së dytë Ftohtë.

Sigurisht, kjo do të varet nga kohëzgjatja e qëndrimit të Putinit në pushtet, dhe nëse Perëndimi mendon se Moska është në të vërtetë mjaft e fortë, për të mbështetur firmosjen e një marrëveshje, të arritur në kushte reciprokisht të pranueshme. Nëse kjo nuk ndodh, presioni do të rritet, duke e shtyrë Rusinë në një gjendje gjithnjë e më të dëshpëruar, nëse ajo nuk mund të përgjigjet në mënyrë të përshatshme ndaj sfidave të jashtme. Në këtë pikë, Moska do të ketë vetëm dy zgjidhje: dorëzimin e plotë sipas kushteve të fituesit, ose fillimin e luftës, si një përpyetje e fundit e dëshpëruar, që mund të rikonfirmojë dinjitetin kombëtar të Ruisë.

Moscow Times



Profecia e Henry Kissingerit / Obama, Meterniku i ri?

Presidenti amerikan ka braktisur iluzionin e eksportimit të demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Kërkon të garantojë stabilitetin përmes ekuilibrit mes fuqive. Ashtu si princi austriak, nxitësi i rimëkëmbjes europiane. Dhe ashtu si dijetari i tij i preferuar: Henry Kissinger

“Vlera më e madhe e një marrëveshjeje me Iranin qëndron në perspektivën e përmbylljes, apo të paktën të ndryshimit, të tre dekadave e gjysmë armiqësi ushtarake kundër Perëndimit, dhe në përfshirjen e Iranit në një përpjekje për stabilizim në Lindjen e Mesme. Irani është një komb i madh, me një kulturë të lashtë, një identitet të fortë, një popullsi të re në moshë dhe të arsimuar. Nëse rishfaqet si partner, do të ishte një ngjarje me përmasa historike”. Ky gjykim vjen nga diplomati më i madh, ende gjallë: Henry Kissinger. Arkitekti i shkrirjes së akujve mes SHBA dhe Kinës, regjisori i udhëtimit historik të Richard Nixonit në

Pekin në vitin 1972, duket se po mendon pikërisht “për atë kombin tjetër me një kulturë të lashtë”, që ai kontribuoi për ta transformuar nga një armik militant të perëndimit, në një partner të globalizimit.

Kur ka shumë pak kohë që ka dalë libri i tij më i fundit, “Rendi botëror”, në SHBA janë të shumtë ata që shfaqin bindjen se Henry Kissingeri është mësuesi i vërtetë i Barack Obamës. Që presidenti këshillohet apo e dëgjon, ky nuk është një mister. Në moshën 91 vjec, ish Sekretarit të Shtetit i janë besuar madje disa misione “joformalë” dhe shumë konfidencialë, në kontaktet me disa qeveri të huaja. Mbi të gjitha, doktrina e re Obama në Lindjen e Mesme duket se është frymëzuar nga ajo realpolitikë, e cila shoqërohet me vetëm tre emra: austriaku Meternik dhe francezi Talleyrand në Tetëqindën, Kissinger në Nëntëqindën. Me realpolitikën janë të lidhura dy kthesat më të fundit të Obamës. Nga njëra anë, hapja ndaj Al Sisit në Egjipt: një pranim indirekt se një udhëheqës autoritar mund të garantojë atë stabilitet që “pranverat

arabe” e kishin prishur, nga Kairo në Tripoli. Një kthesë jo e vogël, nëse e krahasojmë me fjalimin e Obamës në Kairo në qershor 2009, që frymëzoi shpresat për një sezon demokracie dhe të drejtash të njeriut. Kthesa e dytë është ajo pot-huajse-marrëveshje për bërthamoren iraniane: ende e pasigurtë, duke parë që republikanët në Kongresin e SHBA dhe frenimet e papritur në Teheran mund ta sabotojnë.

Tek New York Times, Ross Douthat ka folur për metodën Meternik, sa i përket negociatave me Iranin. (Dhe kur përmendet Meterniku, shfaqet gjithmonë studiuesi i tij më i famshëm, pikërisht Kissingeri). Obama duket se është dorëzuar para faktit që një Pax Americana e re në Lindjen e Mesme mund të funksionojë vetëm duke shfrytëzuar rivalitetet lokale, duke i kundërvënë mes tyre dhe duke i ekuilibruar, për të arritur

herë pas here ekuilibra të përkohshëm që sigurojnë një formë stabiliteti, ndonëse i brishtë dhe provizor. Prej këtu buron edhe baraz- distanca e tij nga sunitët dhe shiitët, nga Arabia Saudite dhe Irani, në shumë konflikte, që nga Siria, në Jemen. Duke braktisur edhe iluzionin e eksportimit të demokracisë, të drejtave të njeriut, të paktën në terma kohëshkurtër.

Është një arsye për të lexuar me vëmendje “Rendin botëror”. Në këtë vepër monumentale, Kissinger riinterpretonte historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, duke u nisur nga Paqja e Vestfalisë që në vitin 1648 i dha fund luftërave fetare në Europë. Fija që përshkon librin e Kissingerit është kërkimi për një metodë, e cila të garantojë paqe dhe stabilitet përmes ekuilibrit mes fuqive dhe mosndërhyrjes në çështjet e brendshme të shteteve sovranë.

Duke rindërtuar historinë e Europës, duke nisur nga epoka në të cilën fanatizmat fetarë në Kontinentin e Vjetër nuk ishin më pak të përgjakshëm se sa xihadi i kohëve të sotëm, Kissingeri e bën paqen e Vestfalisë një model ende të dobishëm, të pasur me mësim. Pikërisht që nga ai moment, njihet në mënyrë përfundimtare sovraniteti i shteteve. Me një konkluzion që sot, sigurisht, nuk është “politically correct”: nëse respekton vërtetë sovranitetin e fqinjit tënd, ajo që ndodh brenda kufijve të tij nuk të përket. Nuk është i pajtueshëm me detyrën e ndërhyrjes humanitare, pra. Etika dhe diplomacia nuk kanë shkuar asnjëherë në pikëpamjen kissingeriane. Të mëdhenj apo të vegjël, të fortë apo të dobët, të gjithë shtetet shihnin tek Traktati i Vestfalisë njohjen e ekzistencës dhe dinjitetit të tyre. Kjo nuk nënkupton që si me magji nisi të mbretërojë aqja dhe harmonia. Pati luftëra të tjera. Të cilat në shumicën e rasteve u përcaktuan prej dy faktorëve. I pari, shfaqja e një fuqie të re në ngjitje, e vendosur që të afirmohet në dëm të fqinjëve të saj. I dyti, futja e një ideologjie “universale”, e vendosur që të impononte vlerat e saj. Tronditja më e madhe për rendin evropian erdhi nga Revolucioni Francez - zëdhënës i vlerave universale - dhe në vazhdim prej Napoleonit. Në Kongresin e Vienës, në vitin 1815, iu shtua një tjetër element rregullave të Paqes së Vestfalisë:

ekuilibri i fuqive. I konceptuar nga Richelieu, zbatuar nga Meterniku dhe Tayllerandi, ekuilibri i fuqive ishte një lojë delikate aleancash dhe kundëraleancash, që kishte për qëllim të shfaqjen e një aktori të vetëm shumë të fortë.

Anglia, në kulmin e forcës së saj, u bë një arbitër, duke zhvendosur herë pas here aleancat e saj për të mos lejuar dominimin e një fuqie kontinentale në dëm të të tjerave (Prusia, Austro-Hungaria, Franca, Rusia). Princërit e Vestfalisë dhe të ekuilibrit mes fuqive, vazhduan që të destabilizohen, sa herë që në skenë shfaqej një ideologji me pretendime universale, që e vetëkonsideronte legjitime ndërhyrjen në punët e brendshme të fqinjëve: fashizmi, nazizmi, komunizmi në shekullin XX. Sot, natyrisht që xhihadi nuk e nje parimin e “Cuius regio, eius religio”: aplikon dënimin me vdekje ndaj jobesimtarëve, dëshiron të bashkojë nën të njëjtën teokraci të gjithë botën islamike, duke eliminuar kufijtë aktualë mes shteteve.

Doktrina Obama mund të arrijë të organizojë një ekuilibër mes fuqive, e në këtë mënyrë të mundësojë edhe atë tërheqje graduale ushtarake që presidenti amerikan e ka dashur gjithmonë? E shtë sërish Kissingeri që shprehet për këtë, në një editorial të shkruar bashkë me një tjetër ish sekretar shteti republikan, George Schulz.

Duke hedhur hipotezën që Irani nuk i respekton marëveshjet, apo që i respekton vetëm për dhjetë vite të parashikuar në të dhe më pas ndërton bombën atomike, Kissingeri ngre pyetjen nëse ekuilibri i fuqive është i zbatueshëm në një garë për armën bërthamore mes Iranit dhe fqinjëve rivalë (Arabia Saudite, Egjipti, Turqia). Ai kujton ekuilibrin e terrorit dhe të vetëpërmbajtjes gjatë luftës së ftohtë: atje protagonistët ishin shtete të qëndrueshëm, ndërkohë që në Lindjen e Mesme shohim luftëra të kryera nga grupe ushtarakë, terroristë, disa prej të cilëve lartësojnë martirizimin. Një skenar shumë i ndryshëm nga stabiliteti që SHBA dhe BRSS garantuan dikur, nga frika e asgjësimit bërthamor reciprok. Një tjetër dyshim i Kissingerit: “Teoria tradicionale e ekuilibrit mes fuqive na mëson që duhet forcuar pala më e dobët, jo ajo që është në ngjitje”. Që është Irani.

Nxënësi Obama nuk ka përfunduar së kaluari provimet e profesor Kissingerit. Statisti është i bindur që “pasionet që nxisin Lindjen e Mesme, bashkë me armët e shkatërrimit në masë, mund ta detyrojnë Amerikën të përfshihet më shumë; Historia nuk do ta bëjë punën që na takon neve; Historia ndihmon atë që di të ndihmojë vetveten”.

I tiji nuk është një refuzim pa të drejtë apelimi. Sic mëson “Rendi botëror”, diplomacia lundron prej shekujsh në kompleksitet. Sipas Kissingerit, që doktrina Obama të ketë sukses, duhet që ta

shtyjë Iranin jo vetëm drejt vetëkufizimit ushtarak, por edhe drejt moderimit politik, që të pushojë së destabilizuar të gjithë vendet fqinjë, përmes forcave aleate të tij (Hamasi, Hezbollahu, grupet e militantëve shiitë). Duke iu përmbajtur, nga ana e tij, një paqeje si ajo e Vestfalisë.



Zbrazëtia e retorikës së Perëndimit

NGA ANA PALACIO

Afro 70 vjet më parë, kur George Orwell ekzaminoi tendencën drejt ambiguitetit, ai ofroi shpjegimin disi të thjeshtë se “fjalimi dhe shkrimi politik janë kryesisht mbrojtja e të pambrojtshmes”. Me fjalë të tjera, gjuha e mjegullt është e nevojshme për të fshehur realitete të pakëndshëm. Dhuna masive kundër popullsisë civile është “paqësim” dhe spastrimi etnik është një “transferim i popullsisë”. Siç thoshte Orwelli, “armiku i madh i gjuhës së pastër është mungesa e sinqeritetit”

Mes sfidave të shumta që has Perëndimi, njëra prej tyre injorohet vazhdimisht: të dhënit pas retorikës boshe. Që nga parulla e papranueshme e Presidentit Barack Obama gjatë mandatit të parë, “të udhëheqësh nga prapa”, deri tek versioni më i fundit gjerman i “udhëheqjes nga qendra”, frazat boshe janë shndërruar në monedha të politikave të jashtme të qeverive perëndimore.

Sigurisht, kompleksiteti dhe paparashikueshmëria e çështjeve ndërkombëtare e forcojnë prirjen e politikanëve për të qenë sa më të paqartë. Dhe sot, me mjedisin gjeopolitik më të komplikuar dhe më pak të parashikueshëm se kurrë, udhëheqësit tanë kanë edhe më pak nxitje për të ofruar atë lloj guximi dhe qartësie që

kërkon një politikëbërje efikase. Fatkeqësisht, një situatë të keqe e kemi përkeqësuar edhe më shumë.

Deklaratat strategjike luajnë një rol të rëndësishëm në sinjalizimin e kundërshtarëve, aleatëve, qytetarëve dhe institucioneve qeveritarë, për drejtimin që merr një vend dhe qëllimet që ai ka. Kur deklarata të tilla kërkojnë interpretime të pafundëm, atëherë impakti i tyre dobësohet dramatikisht.

Kjo nuk do të thotë se nuk ka vend për dykuptimësi në marrëdhëniet ndërkombëtare. Historia është e mbushur me episode, kur ambiguiteti strategjik ka qenë i dobishëm. Për shembull, disa historianë thonë se vendimi, në vitin 1950, i Sekretarit të atëhershëm të Shtetit të SHBA, Dean Acheson, për të përjashtuar “Korenë e Jugut” nga perimetri i mbrojtjes prej SHBA, i dha një sinjal Koresë së Veriut dhe Bashkimit Sovjetik se Amerika nuk do ta mbronte Jugun, edhe nëse sulmohej. Problemi me paqartësinë e sotme është se kjo nuk është strategjike. Mendoni bazën e arsytimit të Barack Obamës për politikën e tij të jashtme – e ashtuquajtura “doktrina Obama” – që ai më në fund e ofroi, në vijim të deklaratës për marrëveshjen-kuadër në lidhje me programin bërthamor të Iranit. “Ne do të angazhohemi, por ne ruajmë të gjithë aftësitë tona”.

Në sipërfaqe, kjo deklaratë ka kuptim. Por ajo na lë me më shumë pyetje, se sa përgjigje. Cfarë sinjali ka lëshuar në të vërtetë Obama? Cilët, sipas këndvështrimit të tij, janë kufijtë e angazhimit të SHBA? Në cilat kushte, SHBA do të përdorte aftësitë e veta?

Afro 70 vjet më parë, kur George Orwell ekzaminoi tendencën drejt ambiguitetit, ai ofroi shpjegimin disi të thjeshtë se “fjalimi dhe shkrimi politik janë kryesisht mbrojtja e të pambrojtshmes”. Me fjalë të tjera, gjuha e mjegullt është e nevojshme për të fshehur realitete të pakëndshëm. Dhuna masive kundër popullsisë civile është “paqësim” dhe spastrimi etnik është një “transferim i popullsisë”. Siç thoshte Orwelli, “armiku i madh i gjuhës së pastër është mungesa e sinqeritetit”. Deri në një farë mase, vëzhgimet e Orwellit janë ende të vërtetë. Por problemi sot është i ndryshëm: politikanët po përdorin politikën e mjegullt, më pak, sepse politikat e tyre janë në thelb të pambrojtshme, dhe më shumë sepse kanë frikë mos u duhet të mbrojnë ndonjë pozicion, cilidoqoftë ai. Ndërkohë që ka një sërë arsyesh për këtë heshtje, kur vjen fjala tek marrëdhëniet ndërkombëtare, dy janë më të spikaturat.

E para është atmosfera politike hiperbolike në demokracitë perëndimore, ku cikli 24-orësh i lajmeve dhe mediave sociale e kanë sjell në rend të ditës politikën e llojit “TE KAPA!” Shtoji kësaj edhe pasigurinë tipike të marrëdhënieve me jashtë, dhe nuk mund të habitesh që politikanët do të preferonin më mirë të nxirrnin nga goja fjali boshe, se sa të rrezikonin të thonin diçka që do t’u plaste mu përpara fytyrës. Në të vërtetë, mjafton të shohësh serinë disa-vjeçare të komenteve – të karakterizuar nga partitizmi, thashethemet, dhe armiqtësia – pas sulmit ndaj ambasadës së SHBA në Bengazi në vitin 2012, për të kuptuar ankthin e udhëheqësve.

Arsyeja e dytë është më themelore: zbehja e sensit të qëllimit dhe bindjes, që karakterizon demokracitë perëndimore sot. Ndërkohë që, për shembull, presidentët John F. Kennedy, apo Ronald Reagan, u përballën qartaz me Bashkimin Sovjetik në fjalimet e tyre në Murin e Berlinit, një seri udhëheqësish perëndimorë kanë folur vetëm me tundje koke dhe shkelje sysh për situatën në Ukrainë, si dhe qëndrimin agresiv të Kinës ndaj fqinjëve të saj.

Nuk është e vështirë të bësh dallimin. Gjatë Luftës së Ftohtë, siguria e Perëndimit se kishte avantazhin moral frymëzonte vetëbesim, në fjalë dhe në vepra. Ndonëse Perëndimi ka ende avantazhin moral në shumë çështje të rëndësishme – si në rastin e Shtetit Islamik, apo pushtimin e Ukrainës nga Rusia – sistemi global sot është i ndarë jo aq qartësisht. Sfidat e brendshme sociale, që kanë vënë në pikëpyetje drejtësinë sociale të modelit liberal të Perëndimit, e kanë forcuar edhe

më heshtjen e politikanëve.

Ndërkohë që udhëheqësit mosbesues perëndimorë ofrojnë mesazhe të ngatërruar, ata lejojnë aktorë cinikë me narrativa më të thjeshta dhe më imponuese, shpesh herë të bazuara në gënjeshtër dhe shtrembërime, që të fitojnë mbështetje me më shumë lehtësi. Në Europë, ngjitja e populistëve demagogë në të dy anët e spektrit politik, e mishëron më së miri këtë fenomen. Po kështu, Presidenti Vladimir Putin, i pashqetësuar prej fakteve apo fajit, ka shfrytëzuar pakënaqësitë e thella dhe pasiguritë në audiencën e brendshme dhe atë ndërkombëtare, për të sajuar narrativa imponuese që mbështesin politikën e tij kundrejt Ukrainës.

Udhëheqësit perëndimorë nuk kanë pse i druhen të vërtetës. Faktet janë në anën e tyre. Ai që nevojitet është vetëbesimi për të mbrojtur rendin ndërkombëtar të ngritur mbi vlerat liberale – dhe të mbështeten argumentat me veprime. Në fund të fundit, deklaratat e forta nuk kanë asnjë vlerë, nëse nuk pasohen me veprime; më keq, ato dëmtojnë besueshmërinë e deklaratave në të ardhmen.

Obama e mësoi këtë në mënyrën më të keqe, kur ai hoqi një “vijë të kuqe” kundër përdorimit të armëve kimike nga Siria dhe më pas nuk arriti të veprojë me forcë, kur Siria e shkeli atë vijë. Doktrina Obama nuk mund të jetë e besueshme, nëse SHBA nuk është e gatshme që të përdorë aftësitë që presidenti është zotuar se do t’i ruajë. Ky është një detyrim i kufizuar jo vetëm tek Obama. Të gjithë politikëbërësit perëndimorë do të duhet të lëvizin përtej konsideratave mendjengush-ta politike dhe anktheve që i kanë mbërthyer, me qëllim që të paraqesin një vizion të qartë strategjik.

Zakoni i retorikës boshe është i vështirë të thyhet. Në të vërtetë, Orwelli paralajmëroi kundër potencialit të tij për të dobësuar mendimin kritik, pasi “çdo frazë e tillë vë në gjumë një copëz të trurit”. Por, ndërkohë që ekuilibri global i fuqive zhvendoset drejt Lindjes dhe drejt Jugut, Perëndimi duhet të bëjë atë që nevojitet për të siguruar vazhdimësinë e influencës së tij – dhe kjo do të thotë marrje e një qëndrimi të vendosur, të qartë dhe të besueshëm ndaj sfidave strategjike që ka përpara.

Marrë me autorizim nga Project Syndicate, 2015. Ripublikimi mund të bëhet vetëm me lejen e Project Syndicate – The Mealy-Mouthed West – BOTA.al



Pse Greqia duhet të marrë parasysh edhe daljen nga eurozona

NGA PATRICK SMITH

Më e ngadaltë se një rul, por më e shpejtë se një akullnajë, Evropa po përparon drejt një marrëveshjeje çështjen greke, dhe ka disa probleme që duhen trajtuar në këtë pikë. Të frikësuar nga përgjigjet, evropianët po bëjnë atë çka u duket se është më e mira, e që është ngurimi. Por kjo qasje nuk mund të zgjasë shumë gjatë. Këtu është lista ime e pyetjeve:

- A mundet Athina, Brukseli, Banka Qendrore Evropiane, dhe qeveria e kancelares Merkel t'i bien problemit në kokë, duke arritur një marrëveshje, që i lejon Greqisë të paguajë borxhet e saj (me disa pauza midis) dhe rikthehet në rritjen ekonomike?
- A do kërkojë një marrëveshje e tillë një rikonceptim të konsiderueshëm të kushteve të shlyerjes së borxhit? Nëse po, sa i rëndësishëm do të jetë?
- Mungesa e një marrëveshjeje të tillë, a mos nënkupton daljen e pashmangshme të Greqisë nga eurozona, edhe pse disa nuk janë ende të gatshëm për ta thënë troç? A është në fakt Grexit, sa i dëmshëm po aq edhe i dëshirueshëm?

• Së fundmi, pyetja kryesore, që çdonjeri duhet ta mendojë: A është Bashkimi Evropian, i aftë për zbatimin e një modeli ekonomik alternativ, në kundërshtim me neoliberalizmin mbizotërues?

Ne mund t'i shohim këto kohë pas kohe, por diçka do ta qartësoja që në fillim:- Gjërat kanë shkuar për keq ose duke mos qenë askund, qëkur Aleksis Cipras dhe partia e tij kundër masave shtërnguese Syriza, formuan qeverinë e re greke në janar.

Për rrjedhojë, do të jetë më mirë për të gjithë të interesuarit, nëse Greqia del nga eurozona. Mos guxoni ta quani këtë pesimizëm. Më mirë shikoni optimizmin e varrosur brenda pesimizmit të dukshëm. Të enjten e kaluar, pas zbrazti dollapin e saj, Athina kreu një pagesë të planifikuar prej 476 milionë eurosh ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar. Tregjet e obligacioneve zbritën shumë; vlera e bonove 10-vjeçare ra me 18 pikë. Por sërish kostoja e borxhit 10-vjeçar grek mbetet e lartë, ndërsa Athina ka blerë shumë pak kohë: Ajo duhet të paguajë 22.5 miliardë dollarë interesa borxhi, vetëm për këtë vit. Numrat përbëjnë thelbin: statuskuoja nuk është e arsyeshme, pa marrë parasysh sesi e ndani suflaqen. Lërimi gjërat kështu siç janë, dhe do të lini pa shpresë një komb 11 milionë banorësh.

Çështja nr.1: Po, qoftë edhe teorikisht BE dhe Athina, mund të arrijnë një marrëveshje. Por kjo nuk është një çështje teknokratike. Ajo është një çështje politike, dhe ka qenë kështu që në fillim. Në pamundësi për të pranuar njohjen e mjerimit ekonomik dhe social që kanë krijuar në Greqi kushtet e shpëtimit aktual, ministrat evropianë i kanë bërë thirrje kryeministrit grek Cipras, të lërë në baltë krahun e tij të majtë dhe të formojë një qeveri-afërsisht të qendrës, le të themi si ajo e kryeministrit Mateo Renzi në Itali.

Ky lloj ndërhyrjeje është e paturpshme, dhe përçon një imazh shumë më të keq mbi BE, sesa mbi Ciprasin dhe ngjyrat e shumta të kuqe dhe rozë në partinë e tij. Në fakt, Evropa është duke thënë se e pranon procesin demokratik, mes vendeve anëtare vetëm kur ajo e cilëson rezultatin përfundimtar të kënaqshëm. Absurde.

Çështja nr.2: Po, nxjerrja e Greqisë nga eurozona, kërkon një rikonceptim shumë të madh të gjithçkaje, dhe nuk është një gjë e mirë që të ndëshkohen të gjithë grekët, për fajet e disave. Në këtë pikë Brukseli dhe Frankfurti, duhet të pranojnë gabimin dhe të ndryshojnë kursin. Për herë të 55, kjo është një krizë evropiane dhe jo vetëm një krizë e Greqisë.

Javën e shkuar, askush tjetër përveç Reza Moghadam, ish-kreu i departamentit Evropian të FMN-së dhe tani nënkryetar në "Morgan Stanley", sugjeroi një mënyrë për ta bërë këtë të mundur. Ai këshilloi përmes një shkrimi në "Financial Times" kthimin sërish tek "kushtëzimet" për disa nga reformat thelbësore, rifinancimi i borxhit menjëherë deri në fund të verës, dhe ndërkohë negocimin e rstrukturimit të pjesës tjetër. Duke patur parasysh se BE preferon të druhet, në vend se të pranojë këtë, bisedimet kanë për të marrë një kthesë të re.

Çështja nr.3: Jo, një dalje greke nga eurozona, nuk është e pashmangshme, por në gjendjen aktuale ajo ngjan si e e dëshirueshme. Valeri Zhiskar D'Estenji, një nga arkitektët e monedhës së përbashkët, e përdori këtë argument muaj më parë. "Çështja kryesore është nëse ekonomia greke mund të rimëkëmbet dhe përparojë apo jo me një monedhë të fortë si euroja"- tha ish-presidenti francez në një intervistë në muajin shkurt për "Les Echos", të përditshmen pariziene mbi biznesin.

"Përgjigja është qartësisht negative. Greqia ka nevojë të jetë në gjendje të zhvlerësojë monedhën e vet"- theksoi ai. Zhiskar apeloj për "një dalje miqësore", duke e lënë derën hapur për një rihyrje në eurozonë, në rrethana më të volitshme në një datë të ardhshme. "Do të ishte absurde të thuhet, se ky është një dështim i Europës. Greqia e ka ende vendin e saj në Bashkimin Evropian"- u shpreh ish-presidenti francez. Opinioni i Zhiskar, mbështetet tek konkurrueshmëria greke. Analiza ime është tërësisht politike. Nëse BE kërkon, që qeveria Cipras ose të pranojë kushtet shtërnguese të ndihmës fuqianciare ose të mbetet përgjegjës para elekto-

ratit të tij, ai duhet të zgjedhë këtë të fundit-për hir të grekëve dhe pjesës tjetër të Evropës gjithashtu.

Një projekt evropian, i demaskuar, dhe që vepron në kundërshtim me vlerat demokratike është i padobishëm për askënd. Dhe duke patur parasysh klimën e tanishme në jug të Europës, nuk ka një lutje në një periudhë afatgjatë. Këtu bazohet edhe optimizmi im: Më mirë ta mbyllin këtë çështje, qoftë edhe përmes daljes së Greqisë, dhe së paku të ruhet tradita demokratike e Evropës: Është thjesht panegociueshme.

Çështja nr.4: Ndonjëherë një hetim filozofik, mbart pasoja shumë praktike, dhe kjo është një prej tyre. Në këtë pikë, Bashkimi Evropian dëshmohej i paaftë të pranojë alternativën e një vendi anëtar ndaj ortodoksisë neoliberales, të ngulitur thellë në mendjet e teknokratëve dhe politikanëve në Bruksel dhe Gjermani.

Në një shkrim në "Financial Times", Martin Sandbu, shprehet se Cipras deri tani ka vepruar në anën e "po"-së: Po, ne mund t'iu servirim grekëve një përzierje, mes stimullit kejnesian dhe demokracisë së majtë sociale, dhe në fund të mbetemi në eurozonë. Ekonomisti i njohur amerikan Xhejms K. Galbraith, në Universitetin e Teksasit, dhe një mik i ngushtë i ministrit grek të financave Janis Varufakis, dëshiron të mendojë për "ndërrhyrje pragmatike" të kancelares Merkel – "dikush, të cilit unë zakonisht nuk i ofroj një marrëveshje të madhe, me një lavdërim të shfrenuar"- sinjalizon një kthesë të pashmangshme në të menduarit evropian. E pra, Cipras deri tani ka shkuar shumë larg në bisedimet e tij me evropianët. Ata nuk arritën askund, madje as nuk i treguan dhëmbët Greqisë. Dhe për Galbraith unë ofroj shprehjen e famshme të Hemingueji në romanin "Dhe dielli lind përsëri:" A nuk është shumë e bukur, për të qenë e vërtetë?/ "The Fiscal Times"



Politika e jashtme turke: një strategji e paqartë

NGA DIDIER BILLION*

Recep Tayyip Erdogan u prit më prill nga homologu i tij iranian Hassan Rohani. Megjithë pikat e mosmarrëveshjeve politike, Erdogan bëri kujdes që të mos i përmendte ato, duke u përqëndruar në kooperimin ekonomik të dy vendeve. Cila është natyra e raporteve ekonomike midis Iranit dhe Turqisë?

Bashkëpunimi ekonomik midis Iranit dhe Turqisë është mjaft konseguent. Në vitin 2012, volumi i shkëmbimeve tregtare midis dy vendeve përfaqësonte rreth njëzet e dy miliard dollarë. Gjatë dy viteve në vijim, u vu re një rënie mjaft e ndjeshme e këtyre shkëmbimeve, meqënëse volumi i tyre ra në trembëdhjetë miliard në vitin 2013, dhe pesëmbëdhjetë miliard në vitin 2014, sidomos për arsye të sanksioneve ndërkombëtare të imponuara Iranit, ku dhe Turqia u përfshi si një numër partnerësh të tjerë tregtarë të Teheranit. Megjithatë perspektiva që u ripohua gjatë këtij udhëtimi ishte të arrihej një volum shkëmbimesh prej tridhjetë miliard dollarë për vitin 2015. Mendoj se ky objektivi është shumë ambicioz,

edhe nëse supozojmë se marrëveshja kuadër e nënshkruar midis grupit P5+1 dhe iranianëve më 2 prill, do të mund të lejojë anulimin progresiv të sanksioneve ndërkombëtare dhe pra në mënyrë indirekte, zgjerimin e tregtisë midis Iranit dhe Turqisë. Duhet kuptuar në fushën e shkëmbimeve tregtare midis dy shteteve, vendin e parë e zënë hidrokarburet. Në mënyrë të pakundërshtueshme, nga ana e Turqisë ka një interes të theksuar mbi këtë çështje, meqënëse ata janë konsumatorë të rëndësishëm të hidrokarbureve dhe se nuk kanë të tilla burime në nivel kombëtar.

Qysh në vitin 1996, është nënshkruar një marrëveshje për gazin midis Iranit dhe Turqisë. Ajo ka të bëjë me lëvrimin vjetor të rreth dhjetë miliard metër kub gaz iranian drejt Turqisë. Kjo vizitë ishte rasti për të dy partnerët, që të trajtonin tetë dosje të tjera ekonomike që përfshijnë perspektivat e krijimit apo thellimit të kooperimit të përbashkët, që përfshin sektorë të ndryshëm si ai i shëndetit, transporteve – sidomos ajror, apo dhe industrinë. Intensiteti i marrëdhënieve ekonomike midis dy vendeve është pra i rëndësishëm, por duhet nënvizuar asimetria që ekziston në zemër të këtyre shkëmbimeve, e kujtuar nga presidenti turk gjatë kësaj vizite. Irani eksporton rreth dhjetë miliard dollarë produkte drejt Turqisë, por importon vetëm pesë miliard dollarë produkte turke. Kjo asimetri është e lidhur kryesisht me faturën e gazit dhe Recep Tayyip Erdogan dëshiron që një ribalancim në shkëmbimet tregtare të bëhet në të ardhmen. Megjithë këtë vështirësi për palën turke, rrjedhshmëria dhe e rëndësia e marrëdhënieve ekonomike midis dy vendeve, qëndron, në mënyrë të pakundërshtueshme, sipër mosmarrëveshjeve politike të cilat mundet të ekzistojnë midis tyre.

Në vitin 2014, Erdogani nuk kishte hezituar ta cilësonte Iranin “atdhe të dytë”. Në vitin 2002, udhëheqësit e AKP zgjodhën adoptimin e politikës “zero probleme” me fqinjët. Kjo strategji, sot po has në vështirësi. Cilat janë raportet që mban Turqia me fqinjët e saj rajonal?

Ish ministri i punëve të jashtme turk dhe sot kryeministri Ahmet Davutoglu, e përdori shumë këtë formulë të “zero probleme” me fqinjët. Kjo bëri që shumë komentatorë ta përdornin këtë formulë për të ilustruar një situatë mjaft të ndryshme: atë të “zero fqinjë pa probleme”. Duhej pranuar se zbatimi i një politike rajonale të ekuilibruar dhe në vetvehte pak të normalizuar nuk është gjë e lehtë kur ke për fqinj shtetet e Kaukazit, Iranin, Sirinë apo dhe Irakun. Kuptohet mirë që secili nga këta fqinjë, për arsye të ndryshme, gjindet përballë proceseve të destabilizimit. Prandaj është shumë e komplikuar për Turqinë të zbatojë një politikë të jashtme rajonale fluide. Dosja më e rëndësishme në rajon aktualisht është në mënyrë të pakundërshtueshme ajo e Sirisë. Është e qartë se në rastin konkret, politika e Turqisë është kryesisht e gabuar. Autoritetet turke kanë kryer një gabim vlerësimi fillestar dhe qysh në vitin 2011, ata kanë përsëritur pa pushim që Bashar al-Assad kishte jetëgjatësi politike të kufizuar dhe ai do të përfundonte duke u dëbuar nga pushteti.

Por pas katër viteve konflikt, presidenca siriane nuk ka ndryshuar dhe grupet më radikale janë forcuar në krahasim me të gjitha grupet e tjera të opozitës. Ky gabim vlerësimi fillestar ka pasoja të tmerrshme për aq bashkëfajësi të heshtur e cila duket se ka ekzistuar midis palëve të aparatit të shtetit, sidomos shërbimeve informative dhe grupeve radikale si përshebull e Frontit al-Nusra. Megjithatë turqit objektivin e tyre kryesor në Siri kanë dëbimin e Bashar al-Assadit nga pushteti. Ata pohojnë se shteti islamik nuk është, sipas tyre, objektivi i parë për të luftuar, duke argumentuar se vdekja e 200 000 civilëve nga fillimi i këtij konflikti i atribuohet regjimit të Bashar al-Assadit. Logjika e tyre është pra krejtësisht e qartë dhe e njëjtë me atë të francezëve dhe britanikëve.

Por ky gabim vlerësimi fillestar shkaktoi vendime të gabuara. Për rrjedhojë, një pjesë e kredibilitetit rajonal të Turqisë, e cila u amplifikua dhe afirmua gjatë viteve 2000, tani është e hapur për pyetje dhe kritika. Krahas kësaj, ka dy shtete të tjera

me të cilët Turqia mban marrëdhënie të vështira. I pari është Izraeli, në raport me çështjen palestineze. Dihet sa të ashpra janë autoritetet turke, me të drejtë për politikën e kolonizimit të bërë nga Benjamin Netanjahu.

Vendi i dytë që mban marrëdhënie konfliktuale me Turqinë është Egjipti, meqënëse Erdogan pa pushim e dënon grushtin e shtetit të komplotuar kundër Vëllezërve Myslimanë nga Marshalli Sissi, presidenti aktual egjiptian. Megjithë këtë Turqia përtej vështirësive të saj për të zbatuar një politikë rajonale të normalizuar, është një vend i rëndësishëm në rajon njëkohësisht për vendin e saj, historinë e saj dhe peshën e saj demografike dhe ekonomike. Pavarësisht nga trazirat dhe vështirësitë rajonale, Turqia është një vend qendror dhe i pashmangshëm në çdo implementim për zgjidhjen e krizave dhe mosmarrëveshjeve që ekzistojnë në Lindjen e Mesme.

Situata gjeografike e Turqisë, vendi midis dy rajoneve: Evropës dhe Lindjes së Mesme. A ka bërë Turqia një zgjedhje midis të dyjave?

Jo, nuk ka zgjedhje në këto kushte. Unë mendoj se marrëdhëniet ndërkombëtare nuk janë kurrë një lojë e shumës zero. Kjo nuk është për shkak se Turqia ka ambiciet legjitime të jetë më me ndikim në Lindjen e Mesme, që ajo duhet medoemos të tërhiqet vis-à-vis Evropës – dhe e anasjellta.

Turqia është në mënyrë të përkryer në gjëndje dhe mjaftueshmërisht e pjekur për të pasur njëkohësisht një politikë sulmuese në nivel ekonomik dhe diplomatik në Lindjen e Mesme, në të njëjtën kohë të vazhdojë negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian. Gjithësesi është e qartë se entuziasmi turk, që u manifestua para dhjetë vjetëve në tetor të vitit 2005 gjatë hapjes së negociatave për hyrjen në Bashkimin Evropian ka rënë, përderisa edhe vetë evropianët janë në krizë dhe intensiteti i negociatave është ulur në mënyrë të konsiderueshme. Madje mund të themi se qysh prej katër vitesh, ka de facto një ngrirje të negociatave. Projekti evropian ndofta duke gjithashtu më pak tërheqës, se sa dhjetë vite më parë për Turqinë.

Në këtë kontekst, unë nuk jam nga ata që ato kanë kthyer faqen evropiane. Unë mendoj që Turqia ka gjithmonë nevojë të mbajë marrëdhënie sa më të mira të mundshme, edhe nëse ato nganjëherë janë konfliktuale, me Bashkimin Evropian. Nëse Ankaraja, në mënyrë krejtësisht hipotetike, do të hynte një ditë në klubin evropian, kjo do të përfaqësonte një rritje të fuqisë, njëkohësisht për Bashkimin Evropian dhe për Turqinë. Në mënyrë të pakundërshtueshme, kjo do t'i jepte të dy aktorëve më shumë peshë në rajon. Çështja qëndron në se Bashkimi Evropian dëshiron të ketë një politikë të jashtme të përbashkët, për të cilën mund të dyshojmë. Sipas mendimit tim, BE-ja nuk ka zgjedhje për t'i imponuar Turqisë. Kjo e fundit mundet në mënyrë të përsosur të jetë e pranishme në të dyja tabelat, ka madje një interes të përbashkët të forcohen më mirë marrëdhëniet turko-evropiane për të qenë, sëbashku, më proaktive në Lindjen e Mesme.

* **Studjues, Instituti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare Strategjike, Francë**



Ja se si u arrit në monedhën e Euros

NGA GIORGIO LA MALFA

Elita të vendosura, bankierë të pakujdesshëm dhe coincidenca të historisë. Si u arrit në monedhën e trazuar

Ndodhia e krijimit të Euros është vërtet e jashtëzakonshme. Sa më shumë studiohet, aq më shumë duket e habitshme. Është historia e një monedhe që nuk duhej të lindte, pasi pothuajse asnjëri nuk ishte në favor të një projekti me këtë shtrirje dhe që në fakt, nëpërmjet zinxhirit të një serie rrethanash, u bë një ide e pandalshme. Dhe pikërisht pse në thelb

askush nuk kish besuar se vërtet do të arrihej në një monedhë të vetme për Europën, kur ajo ka parë dritën, është kuptuar se kishte shumë aspekte të problemit, lidhur me të cilat nuk ishte reflektuar sa duhej.

Në gjysmën e dytë të viteve Tetëdhjetë të Nëntëqindës, kur fillon kjo histori, reshtimi i atyre “kundër” ishte i gjerë dhe i fuqishëm. Bënin pjesë Bankat Qendrore të 12 vendeve, që atëhere përbënin Komunitetin Europian, ndoshta me përjashtim të Banca d’Italia e Carlo Azeglio Ciampit dhe të Banca di Espana. Fuqimisht kundër qenë në veçanti dy bankat qendrore më të rëndësishme: Bundesbank i drejtuar nga sanguini Karl Otto Pöhl dhe Bank of England e drejtuar nga Robin Leigh- Pemberton, një loose cannon – një peshë e lehtë për më tepër e pakontrollueshme – në gjykimin e pamëshirshëm të Nigel Lawson, Kancelarit të Skakierës së atëhershëm, por që gjithsesi kishte prapa krahëve vullnetin e hekurt të Zonjës Thatcher. Qenë kundër në thelb qeveritë evropiane, pavarësisht se të gjitha, përveç Anglisë, deklaroheshin me fjalë në favor të idesë së një Bashkimi

ekonomik dhe monetar. Dhe në çdo rast idetë e tyre lidhur me organizimin dhe qëllimet e Bashkimit qenë aq të larmishme dhe aq kundërshtuese midis tyre, sa të siguronin se ishte shumë vështirë që të mund të binin dakord midis tyre lidhur me një projekt konkret.

Edhe opinionet e ekonomistëve dhe të ekspertëve, në shumicën dërrmuese të tyre, qenë tejet negative. Ekonomistët amerikanë shprehnin hapur dyshimet e tyre, ndërsa europianët, megjithëse duke mos i injoruar problemet dhe vështirësitë e futjes së një monedhe unike në vende kaq të ndryshëm mes tyre, preferonin që të mos e thëllonin shumë diskutimin, për të mos u akuzuar për europianizëm të pakët. Së fundi, këtyre vështirësive i shtohet fakti që futja e një monedhe evropiane nuk parashikohej nga traktatet evropiane në atë kohë në fuqi, dhe kështu që kërkohej miratimi i një traktati të ri, me të gjithë vështirësitë që do të sillte një gjë e tillë.

Në të vërtetë, pavarësisht kësaj tërësie rrethanash negative, në një pikë të caktuar, midis viteve 1988 dhe 1989, u hartua projekti i një Bashkimi monetar evropian dhe, kur menjëherë më pas ideja u vu në lëvizje, marshimi i tij u bë i pandalshëm. U negociua me ngut një traktat i ri, i nënshkruar në Maastricht në shkurtin e vitit 1992, në të cilin kapitulli kryesor kishte të bënte me Bashkimin Monetar Evropian. Përveçse në Francë, ku një referendum i premtuar në mënyrë të pamatur nga Francois Mitterrand rrezikoi që të hidhte në erë gjithçka, ratifikimet e traktatit qenë shumë të shpejta (për shembull, Parlamenti italian që ndër më të nguturit dhe më pak reflektuesit). Në fund të vitit 1993, traktati hyri në fuqi. Më pak se 5 vite më pas lindi Banka Qendrore Evropiane. Njëkohësisht me krijimin e Bankës, u individualizuan 11 vendet e para anëtare të Eurozonës. Nga 1 janari i 1999, politika monetare kaloi në duart e Bankës Qendrore Evropiane. Tri vjet më vonë hynte në qarkullim euro. Si ndodhi kjo lloj amnezie kolektive që mundësoi të realizohej me ngutin maksimal një projekt për të cilin sot, në harkun e pak viteve, edhe shumë prej atyre që atëherë qenë në favor, kanë përfunduar duke u distancuar prej tij? Është një ndodhi që meriton të rindërtohet, edhe në dritën e një libri të çmuar relativisht të vonshëm të titulluar "Making the European Monetary Union" (shtëpia botuese Harvard University Press, Cambridge Massachussetts 2012), i shkruar nga studiuesi Harold James duke mundur të përdorë, përkrah dokumentave zyrtare, edhe letrat e atyre viteve të ruajtura në arkivat e Bankave Qendrore dhe të Bankës së Rregullimeve Ndërkombëtare të Bazelit. Historia mund të tregohet si një lloj pjese teatrale me dy akte dhe shumë skena. Akti i parë u zhvillua në gjirin e një komiteti për studimin e Bashkimit ekonomik dhe monetar evropian, i ngritur nga Këshilli Evropian i Hannoverit në qershorin e vitit 1988. Komiteti i kryesuar nga Jacques Delors, në atë kohë President i Komisionit Evropian, i zhvilloi me shumë shpejtësi punimet e tij dhe e dorëzoi raportin përfundimtar, të miratuar me unanimitet nga përbërësit e tij, në prillin e 1989. Kurse akti i dytë filloi me 9 nëntor të 1989 me rënien e Murit të Berlinit dhe përfundoi në Maastricht të Hollandës, me nënshkrimin e traktatit me të njëjtin emër, me 7 shkurt të 1992. Në mes ndodhi bashkimi i Gjermanisë që peshoi në mënyrë vendimtare mbi rrjedhën e ngjarjeve.

Personazhi kryesor i gjithë kësaj ndodhie, në aktin e parë, ashtu si edhe në të dytin, qe Jacques Delors, i cili atëherë kryesonte Komisionin Evropian me një energji dhe me një prestigj që asnjë prej pasuesve të tij nuk e ka pasur më. Në krah të tij patën një rol të rëndësishëm disa funksionarë të lartë evropianë, midis të cilëve më i kthjellëti qe italianii Tommaso Padoa-Schioppa, në ato vite Drejtor i Çështjeve Monetare të Komisionit Evropian. Delors ishte i shtyrë nga bindja se nuk qenë më të mjaftueshëm hapat e pjesshëm me të cilat zhvillohej procesi i integritimit evropian dhe ndoshta ishte i nevojshëm një hop cilësor në gjirin e bashkimit politik të kontinentit. Për ta realizuar, duheshin shtrënguar qeveritë dhe Bankat Qendrore, të fortifikuara siç ishin në mbrojtje të sovraniteteve kombëtare

nga të cilat dukej se varej pushteti i tyre. Në aktin e parë, me Delors ndërvepruan guvernatorët e Bankave Qendrore; ndërsa në të dytin hyjnë në skenë qeveritë evropiane të kohës.

Akti i I-rë. Skena e I-rë. Lind komiteti Delors

Qershor 1988. Jacques Delors bind krerët e shteteve dhe të qeverive europiane që të krijojnë një komitet të urtësh për studimin e Bashkimit ekonomik e monetar europian dhe ta emërojnë President të tij. Ideja nuk i pëlqeu pothuajse askujt.

Dakord me Kancelarin gjerman Helmut Kohl, Delors vendos që të thërrasë për të bërë pjesë në komitet “me titull personal” guvernatorët e Bankave Qendrore të 12 vendeve anëtare (plus tri ekonomistë dhe një Zëvendëspresident të Komisionit). Është gjetja e parë. Guvernatorët, energjikisht kundër idesë për të studiuar krijimin e një djallëzie tjetër europiane të destinuar, dyshon Karl Otto Pöhl, Presidenti i Buba-s (siç quhej më përkëdheli Bundesbanku), që të fusë hundët në kompetencat e tyre si tutorë të rreptë të stabilitetit, por nuk mund të mos qetësohen sadopak duke qenë të thirrur për të qenë pjesë e komitetit. Edhe Zonja Thatcher, armike ndaj çdo propozimi të ardhur nga Brukseli (dhe në veçanti nga Delors), qetësohet disi pasi me dy qen roje si Pöhl dhe Robin Leigh-Pemberton, kreu i Zonjës së Vjetër të Threadneedle Street (siç quhet në mënyrë të familjarizuar Bank of England në Londër), komiteti nuk do të qullojë asgjë.

Akti i I-rë. Skena (dhe gjetje) e II-të. Fillon komiteti

Në mbledhjen e parë Delors shpjegon se detyra e komitetit nuk është ajo që të diskutojë nëse të bëjë apo jo Bashkimin Ekonomik dhe Monetar. Detyra e tyre, thotë ai, është ajo që të shkruajnë një manifest politik lidhur me integrimin europian, është (vetëm) ajo e kryerjes së një eksplorimi teknik sesi të organizohet një Bashkim Monetar Europian, në rastin ku politika vendos që të procedojë në këtë drejtim. E paraqitur kështu, edhe më skeptikët midis guvernatorëve i hyjnë punës duke menduar, siç e tha njëri prej tyre, se detyra ishte ajo që të shpjegohej saktësisht “se çfarë do të thoshte Bashkim dhe sidomos sesa ishte i vështirë ai”. Delors shtoi se mbledhjet duhej të ishin tejet të rezervuara në mënyrë që të reduktohej sa më shumë të ishte e mundur interferencat e jashtme, domethënë tentativat e qeverive për t’u përzier në vendimet e guvernatorëve. Krijohet kështu një shpirt grupi dhe lihen praktikisht në errësirë qeveritë lidhur me atë se çfarë komiteti po diskuton dhe se në çfarë drejtimi po ecin gjërat.

Akti i I-rë. Skena e III-të. Mbledhjet e komitetit Menaxhimi i një serie primadonash tejet vanitoze siç janë në fakt guvernatorët (përveç Pöhl dhe Leigh-Pemberton, duhet shtuar midis protagonistëve edhe francezin Jacques de Larosière) duhet të ketë qenë mjaft i komplikuar. Por Delors është mjaft i aftë. I drejton guvernatorët drejt përshkrimit të arkitekturës së sistemit të ri që më shumë u afrohet idealeve dhe ëndrrave të tyre të pavarësisë nga pushteti politik. Në mënyrë të veçantë, Delors i jep Pöhl detyron që të përcaktojë karakteristikat e një Banke Qendrore Europiane dhe Pöhl – “a broken reed”, një person i dobët dhe jo i besueshëm, do të shkruajë më pas Kancelari i Skakierës, pasi ka thënë në mbledhjen e parë se komiteti duhet ta heqë qafe idenë e Bashkimit monetar dhe t’u shpjegojë politikanëve “se në këtë moment nuk ekziston një shans realist për të ndërtuar një bashkim monetar”, përfundon rob i vetë propozimeve të tij, duke përshkruar një Bankë Qendrore që i ngjan në dhe për gjithçka Buba-s. Konvertimi i Pöhl sjell me vete atë të Robin Leigh-Pemberton, qenit roje tjetër që kishte pasur nga qeveria e tij detyrën e vigjilimit që komiteti të mos qulloste gjë. Thatcher, e cila nuk duhet ta kishte ndonjë opinion të lartë, i kishte thënë: “Unë kam besim tek Pöhl. Nëqoftëse ai propozon ndonjë gjë, ndiqe”. Kështu, me “rekrutimin” e Pöhl, ishte në bord edhe Leigh-Pemberton. Në demonstrim të zgjuarësisë së tij, ekziston një letër e tij për Kancelarin e Skakierës përpara mbledhjes së parë në të cilën lexohet se në gjirin e komitetit “pragmatistët kanë në dorë gjënë; me sa duket janë mazhoranca; idealistët janë të heshtur dhe Delors neutral”!!!!

Akti i I-rë. Skena e fundit. Konkluzionet e komitetit

Në fillim të prillit 1989, Delors sjell një tekst final që në thelb përcakton udhëtimin me tri faza drejt Bashkimit Monetar të adoptuar më pas në Maastricht. Modeli i Bankës Qendrore është ai i Bundesbankut. Objektivi i politikës monetare është stabiliteti i çmimeve. Financat publike e vendeve anëtare duhet të mbahen nën kontroll. Guvernatorët nguten që të konkludojnë, të bindur veç të tjerave se qeveritë gjithsesi nuk do të bëjnë asgjë. Argumenti si të thuash përfundimtar është i Leigh-Pemberton: “Nëqoftëse ua tregoj këto letra të mallkuara Thesarit, atyre u shkatërrohen nervat... Nëqoftëse përfundojmë pas një jave, do të më kërkohen të bëj amendamente të tjera... Unë kërkoh që të shpëtoj nga kjo bela”. Kështu që është guvernatori i vendit më kundra, i Mbretërisë së Bashkuar, ai që në fund e shtyn në port anijen e Delors. Kështu përfundon akti i parë. E megjithatë, siç është thënë, ka mundësi që kryevepra taktike e Delors nuk do të kishte çuar tek monedha e vetme nëse historia nuk do të kishte bërë pjesën e mbetur. Qeveritë nuk kishin kurrfarë dëshire që të procedonin me Bashkimin Ekonomik e Monetar, as pas prezantimit të Raportit Delors në prillin e 1989. Problemet qenë tejet të komplikuar. Për të miratuar një traktat të ri nevojitej miratimi unanim i vendeve anëtare. Zonja Thatcher nuk e mendonte aspak. Por ra Muri i Berlinit dhe perspektiva e ribashkimit të Gjermanisë ndryshoi sa hap e mbyll sytë gjithçka.

Akti i II-të. Skena e I-rë. Bie Muri i Berlinit

Rënia e Murit të Berlinit nuk gjeneroi asnjë valë gëzimi në kancelaritë evropiane. Në Kujtimet e saj, zonja Thatcher tregon në mënyrë dinake se Mitterrand i telefonon të nesërmen e rënies së Murit dhe i thotë se në momentet e rrezikut Franca dhe Anglia duhet të krijojnë front të përbashkët. Rrezik? Natyrisht, ribashkimi gjerman. Giulio Andreotti, që mendonte se ishte hokatar, tha gjatë atyre ditëve se e donte aq shumë Gjermaninë sa që shkaktonte kënaqësi fakti që qenë dy të tilla. E kështu me radhë. Europa pyeste sesi do të mund të shmangej që Gjermania të vraponte e vetme në lëndinat e Europës Lindore. Dhe kështu Mitterrand i erdhi në mendje – ndoshta qe edhe Delors ai që mund t’ia ketë sugjeruar – se, në rast se nuk mund të shmangej ribashkimi gjerman, ndaj të cilit amerikanët qenë në favor, mund të ofrohej marrëveshja evropiane ndaj unifikimit në shkëmbim të heqjes dorë nga doçmarka nga ana e Gjermanisë. Kështu, brenda pak javësh, u nis në drejtim Maastricht.

Akti i II-të. Skena e II-të

4 janar 1990. Më pak se 2 muaj pas rënies së Murit të Berlinit, Kohl dhe Mitterrand u takuan. Në komunikatën finale, duke cituar sëbashku nisjen e negociatave për ribashkimin gjerman dhe ato për krijimin e Bashkimit monetar. Treni nisët. Po të gjitha dyshimet dhe paqartësitë lidhur me praninë e kushteve të nevojshme për suksesin e monedhës së vetme? Të flakura tej nga urgjenca e zgjedhjeve politike. Bundesbanku ishte dhe mbetej kundër, por nga njëra anë Pöhl nuk mund të distancohej më nga një projekt i Bankës Qendrore Evropiane të bërë sipas modelit të Bundesbankut dhe nga tjetra Kancelari Kohl nuk donte pengesa ndaj bashkimit gjerman. Dhe kështu është shkuar drejt monedhës së vetme pa mbajtur parasysh kushtet ekonomike dhe politike që do të mund t’i siguronin suksesin dhe pa rënë vërtet dakord sesi ta bënin të funksiononte.

Kusuri është histori e vonshme, përfshi këtu rezultatet e zgjedhjeve në Greqi dhe euroskepticizmin në rritje në të gjithë Europën, në jug, ashtu si edhe në veri. Intendance sivra, thoshte Charles de Gaulle duke folur për primatin e politikës ndaj ekonomisë. Por në këtë rast intendance nuk ka pasuar dhe nuk pason. Ja pse jemi në një det belashë.

*** Giorgio La Malfa është politikan dhe akademik italian. Këtë artikull e ka botuar për Il Popolo.**



A është racional Irani?

NGA FAREED ZAKARIA

Racional nuk do të thotë i arsyeshëm. Do të thotë që regjimi dëshiron të lulëzojë, dhe duke patur parasysh këtë objektiv, ai llogarit kostot dhe përfitimet dhe vepron në përputhje me to. A janë veprimet e Teheranit një përgjigje e kuptueshme ndaj situatës së tij gjeopolitike? Në një debat publik javën që kaloi, ish Sekretari i Shtetit, James Baker tha se çelësi i suksesit në negociatë është që të vendosesh në vendin e kundërshtarit dhe ta shohësh botën nga pikëvështrimi i tij. Shihni hartën e Lindjes së Mesme. Irani shiit është i rrethuar nga shtete sunitë armiqësorë...

Në qendër të shqetësimeve përreth marrëveshjes me Iranin ka një pyetje të thjeshtë: A është racional Irani? Për shumë kritikë, përgjigja është e vetëkuptueshme. Iranianët janë “apokaliptikë”, ka thënë shpesh kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, duke paralajmëruar se “nuk mund të vësh bast për racionalitetin e tyre”. Senatori Lindsey Graham ka deklaruar: “Mendoj se ata janë të çmendur”. Ministri i Mbrojtjes i Izraelit, Moshe Ya’alon e ka përsëritur mendimin e tij kohët e fundit, se qeveria iraniane është “një regjim mesianik dhe apokaliptik”.

E megjithëkëtë, politika e preferuar e po këtyre kritikëve, mbështetet mbi racionalitetin e Iranit. Alternativa e marrëveshjes së arritur mes Iranit dhe gjashtë fuqive nuk është lufta, këmbëngulin ata, por rritja e trysnisë dhe kërkimi i më shumë lëshimeve prej teheranit. Kështu pra, kjo bandë e çmendur, apokaliptike mullahësh, kur të përballlet me pak sanksione më shumë, do të llogarisë ftohtë kostot dhe përfitimet dhe pastaj, në një mënyrë të parashikueshme, do të dorë-

zohet përballë rritjes së trytnisë. Ose siç shkruan J. J. Goldberg: “Si duket, ata qenëkan joracionalë sa duhet për të mirëpritur Armagedonin, e në të njëjtën kohë aq racionalë sa të jepen përballë ndëshkimit ekonomik”.

Në librin e tij “E pamendueshme: Irani, bomba dhe strategjia amerikane”, Kenneth Pollack shqyrton me kujdes dekada të tëra të politikës së jashtme iraniane, dhe tregon se ajo ka qenë jo vetëm racionale, por e matur, duke shtyrë përpara sa herë që sheh një mundësi, duke u sprapsur sa herë që nuhat rreziqe. Ai citon një ish shef shtabi të famshëm izraelit, që ka thënë: “Regjimi iranian është radikal, por ai nuk është joracional”.

Racional nuk do të thotë i arsyeshëm. Do të thotë që regjimi dëshiron të lulëzojë, dhe duke patur parasysh këtë objektiv, ai llogarit kostot dhe përfitimet dhe vepron në përputhje me to. A janë veprimet e Teheranit një përgjigje e kuptueshme ndaj situatës së tij gjeopolitike? Në një debat publik javën që kaloi, ish Sekretari i Shtetit, James Baker tha se çelësi i suksesit në negociata është që të vendosesh në vendin e kundërshtarit dhe ta shohësh botën nga pikëvështrimi i tij.

Shihni hartën e Lindjes së Mesme. Irani shiit është i rrethuar nga shtete sunitë armiqësorë. Përtej, në Gjirin Persik qëndron Arabia Saudite, armiku i tij fanatik anti-shiit dhe i mirëarmatosur. (Vitin që kaloi, Arabia Saudite ishte importuesi më i madh i armëve në planet). Në Irak dhe në Siri, Irani përballet me kryengritje të mëdha sunitë që janë të përkushtuara për të masakruar shiitë. Shtoi kësaj edhe dimensionin bërthamor. Irani ka disa fqinjë që zotërojnë armë bërthamore – Pakistanin, Indinë, Rusinë, Kinën dhe Izraelin.

Plus, Irani është përballur me kundërshtimin aktiv të superfuqisë së botës për më shumë se tre dekada. Kur Iraku sulmoi Iranin pak kohë pas Revolucionit Islamik, Shtetet e Bashkuara mbështetën heshturazi Sadam Huseinin, edhe pse ai përdori armë kimike kundër iranianëve.

Seymour Hersh ka shkruajtur gjerësisht në revistën Neë Yorker për mbështetjen e fshehtë që SHBA u ka dhënë grupeve brenda Iranit, që synojnë jo vetëm të rrëzojnë regjimin, por edhe ta shpërbëjnë vendin. Disa prej këtyre grupeve, si Mujahideen-e Khalq dhe Jundallah, shihen si shumë pranë terroristëve. Për një dekadë duke filluar nga viti 2011, Teherani ka parë tekta 200 mijë trupa amerikane janë grumbulluar në kufirin e vet lindor dhe perëndimor, në Irak dhe Afganistan.

Administrata Bush foli hapur për nevojën e “ndryshimit të regjimit” në Teheran, i cili u përfshi në të famshmin “Boshtin e të Keqes”.

Nuk po dua të them që këto politika duhej të ishin ndryshuar – politika ndërkombëtare është shumë e vështirë – por duke parë këta realitete, a është vërtetë kaq e çuditshme që Irani është sjellë në këtë mënyrë? Apo që është përpjekur të ndërtojë një industri bërthamore që mund t’i hapë shtegun drejt një arme bërthamore? A do të kishte vepruar ndryshe një vend laik, super-racional, i gjendur përballë të njëjtëve rreziqe?

Në vitin 1963, John F. Kennedy parashikoi që brenda një dekade, bota do të kishte 15 deri 25 shtete me armë bërthamore. Arsyeja përse e bëri atë deklaratë ishte se në atë kohë, teknologjia bërthamore ishte diçka që çdo shtet me një bazë serioze industriale dhe shkencore mund ta arrinte. (Prandaj India dhe Pakistani u bënë shtete bërthamore). Sot, kjo është edhe më e vërtetë. Shkrirja bërthamore nuk është ndonjë teknologji e përparuar e shekullit 21. Tashmë ajo është 70-vjeçare, me fillesë në epokën e televizionit bardhë e zi.

Parashikimi i Kennedyt nuk rezultoi i vërtetë sepse komuniteti ndërkombëtar, i udhëhequr nga SHBA, është përballur me aspirantët duke u paraqitur kosto reale, por edhe përfitime reale. (Edhe Ghedafi hoqi dorë nga armët bërthamore pas disa vitesh kërcënime, pasi iu ofruan disa stimuj). Kuadri i Lozanës duket se e ofron këtë ekuilibër për Iranin. Nuk ka garanci që Lideri Suprem i Iranit do të pranojë shkëmbimet, por kjo ofertë e detyron atë që të bëjë një llogaritje racionale dhe të jetojë me pasojat. /The Washington Post/



Zgjimi i “Shtëpisë së Saudëve”

NGA BENJAMIN BARDHE

Mbreti i ri Salman synon të bashkojë vendet sunite, me qëllim që t'i kundërvihet ndikimit të Teheranit

A e ka gjetur bota arabo-sunite qendrën e saj të gravitetit? Kjo sugjerohet nga hyrja në luftë e Arabisë Saudite, në fund të marsit, kundër milicëve hutistë të Jemenit, në të cilën tetë vende janë angazhuar në çast, përfshirë dhe Pakistanin, aleatin historik të mbretërisë. “Riadi rimori inisiativën, për interesin e tij dhe atë të rajonit”, pohon gazetari saudit Jamal Khashoggi, i cili gëzon të drejtën të hyjë në të gjithë pallatet e vendit. “Ky është fillimi i një plani të destinuar për t’ia prerë barin nën këmbë iranianëve, kudo ku të mundemi”.

Këto vitet e fundit, mungesat e përsëritura të ish mbretit Abdallah, i sëmurë rëndë, dhe elektroshoku i “pranverave arabe”, fatal për aleatin e tij kryesor në rajon, egjiptianin Hosni Mubarak, e kishin bërë shtëpinë e Saudëve pothuaj pa zë. E hutuar nga mosangazhimi i mbrojtësit të saj amerikan në Lindjen e Afërme, Arabia Saudite nuk kishte mundur t’i kundërvihej përpjekjeve të Katarit dhe të Turqisë, kumbarët e Vëllazërisë Myslimane, për t’u imponuar si padron i ri i rajo-

nit. Përveç se në arqipelagun e vogël të Bahreinit, ku trupat e tij kishin mposhtur në vitin 2011 lëvizjen e protestës me dominim shiit të dinastisë Khalifa, Arabia Saudite la pothuajse të papenguar shtrirjen e zonës së influencës të Iranit: në Liban, ku aleatët e tij të Hezbollahut paralizojnë funksionimin e institucioneve; në Siri, ku forcat dhe fondet e tij mbajnë regjimin e Assadit në gjëndje jete artificiale; në Irak, ku milicët e tij rimorën shërbimin nën maskën e luftës kundër xhihadistëve të organizatës së Shtetit Islamik; dhe pra në Jemen, ku hutistët, një lëvizje e armatosur e minoritetit zaïdit (një degë e shiizmit) dhe e mbështetur nga Teherani, kapën në vjeshtë Sanën, duke detyruar presidentin e zgjedhur, Abed Rabo Mansour Hadi, të mirrte arratinë.

Por ardhja në pushtet e mbretit Salman, në janar, i mbështetur nga dy ministrat e brezit të dytë me karakter të fortë, djali i tij Mohamed Ben Salman ministër i mbrojtjes dhe nipi i tij, Mohamed Ben Nayef ministër i brendshëm, ndryshoi lojën.

Më 26 mars, duke dërguar avionin e tij të bombardonte pozicionet hutiste, shërbëtori i ri i dy xhamive të shenjta – siç i quan zyrtarisht sovrani saudit – i ra de facto orës së zgjimit sunit.

Indiferent ndaj faktit që ky sulm mund të dëmtojë Shtetet e Bashkuara, për negociatat mbi çështjen bërthamore iraniane, Riadi ka manifestuar një autoritet të pazakontë, duke detyruar Uashingtonin të bekojë bombardimet. “Sauditët kanë kuptuar që ata nuk mund të mbështeten vetëm mbi veten e tyre”, shprehet një diplomat perëndimor me post në Arabi.

“Ata morën përsipër të mbledhin fuqitë sunite rreth tyre, për të penguar influencën destabilizuese të Iranit”. Në fjalimin e tij të ditës së premte, imami i xhamisë së madhe të Riadit insistoi në faktin që operacioni “Stuhia vendimtare”, emri i kodit të ndërhyrjes në Jemen, i “dha shpresë Oumma-s”, komuniteti i besimtarëve.

Edhe përfundimi i marrëveshjes midis Iranit dhe fuqive të mëdha, më 2 prill, e cila mund të çojë në riintegrimin në bashkësinë e kombeve të armikut të tyre të betuar, nuk ka filluar të shfaqë krenarinë e re të sauditëve. “Arabia saudite ka marrë përsipër lidërshtipin arab, shprehet me entuziazëm Abdelaziz Al-Moureidib, një afarist në Riad. Kishte një kohë të gjatë që unë nuk i kisha parë bashkëkombasit e mi kaq të lumtur”.

Frymë nacionalizmi

Mbrapa kësaj fryme nacionalizmi, e ushqyer nga propaganda e shtetit, Jamal Khashoggi zbulon një kthesë autentike: ardhja në fuqi e një “doktrine Salman”, një intervencionizëm anti-iraniane, i dekompleksuar dhe kundër një palëvizshmërie që karakterizonte këto kohët e fundit diplomacinë saudite.

Mbreti fitoi me këtë teori presidentin e Egjiptit Abdel Fattah Al-Sissi. Flota e tij është dislokuar në ngushticën e Bab Al-Mandebit, rrugë hyrje në kanalën e Suezit, dhe filloi të bombardojë Adenin. I pakënaqur se nuk kishte rigjetur besnikun e dytë që i mungonte atij qysh prej vitit 2011, mbreti Salman mund gjithashtu të jetë krenar që solli Katarin nën tutelën e tij dhe që ngrohu përsëri marrëdhëniet e tij me Ankarën. Edhe Sudani, që thuhet se është i afërt me Iranin, i është bashkuar frontit anti-Teheran, një koalicion i gjerë arab që s’ishte parë asnjëherë qysh prej luftës së vitit 1973 kundra Izraelit. Pas Jemenit, është çështja bërthamore që “doktrina Salman” do të mund të ketë një zbatim konkret.

Në mes të muajit mars, Turki Ben Faisal, ish spiun mjeshtër i mbretërisë kishte paralajmëruar që në rast marrëveshje midis perëndimorëve dhe Iranit monarkitë e Gjirit do të kërkonin të njëjtat të drejta që i kishin dhënë Republikës islamike. “Nëse Irani arrin kapacitetin të pasurojë uraniumin në një nivel të tillë, Arabia Saudite do të kërkojë të njëjtën gjë dhe ajo nuk do të jetë e vetmja”, kishte deklaruar ky anëtar me influencë i familjes mbetërore.

Jamal Khashoggi, i cili ka veshin e princit Turki, i paraprin një politike më të

vendosur për dosjen siriane. “Vendime të ndjeshme për të ndryshuar lojën në terren janë marrë, paralajmëron ai. Mundet të bëhet fjalë për vendosjen e një zone ndalim-fluturimi në Veri, lëvrime në sasi të mëdha raketash tokë-ajër, apo dhe materiale të tjera.

Fitoret e kohëve të fundit të rebelëve në Idlib [kryeqytet provincial në veri të vendit] dhe në Nassif [pikë kufitare me Jordaninë] janë indikatorë të zhvillimeve të ardhshme”.

Kontraktori kryesor i kësaj politike të re proaktive është ministri i mbrojtjes, Mohamed Ben Salman, një tridhjetë vjeçar, që shërben gjithashtu si shef i kabinetit të mbretit. Impulsiviteti dhe mungesa e tij e përvojës në fushën ushtarake i shqetëson disi diplomatët e huaj. Fotomontazhe që e paraqesin atë si luan, duke vrarë udhëheqësin e lartë iranian, Ali Khamenei, shefi i Hezbollahut, Hassan Nasrallah, dhe lideri hutist Abdel Malik Al-Houthi, qarkullojnë tashmë në Twitter. Disa vëzhgues presin që presidenti Sissi, me të përfunduar operacioni jemenit të bashkohet me mbretin Salman duke i kërkuar atij të mbështesë një dalje të re, madje këtë radhë të marrë pjesë, në Libi, kundër milicëve xhihadistë. “Kjo është tendenca e vështirë në rajon, konstaton një specialist i Arabisë Saudite”, që dëshiron të ruajë anonimat. “Së pari bombardojmë, dhe më pas reflektojmë”.

Për Jemenin, sauditët sigurisht sigurojnë që kanë një plan: rivendosjen e autoritetit legjitim të presidentit Hadi dhe rifillimin e dialogut politik. Por gjashtë muaj pas rënies së Sanasit, në kaosin që mbizotëron në terren, këto objektiva duken utopike. Të dehur nga rizbulimi i fuqisë së tyre, sauditët do të duhet të gjithashtu të kuptojnë se kjo nuk është pa kufizime. /Le Monde/



Përleshja mes sunitëve dhe shiitëve: Ka filluar sërish Loja e Madhe

Një përpjekje për të shpjeguar Lindjen e Mesme. Teksa regjimet e vjetër po shemben, shiitët dhe sunitët po luftojnë për dominim. Loja e Madhe, me sa duket, sapo ka nisur – dhe vite të tërë kaosi dhe konfliktesh të dhunshëm tashmë duken të pashmangshëm. “Në shekullin 20, secili shtet kishte vendin e tij në skenë”, tha një ekspert i rajonit që punon në Universitetin e Tel Avivit. “Tani i kemi hyrë një udhëtimi drejt një kapitulli të panjohur në Lindjen e Mesme”

Përse Lindja e Mesme është e zhytur në trazirë?

Në më shumë se dhjetë shtete, tiranët që dikur sundonin përmes frikës dhe represionit janë rrëzuar, duke shkaktuar kështu rishfaqjen e rivaliteteve sektarë disashekullorë për pushtet. Lufta civile e tmerrshme në Siri po përhapet në Liban dhe po kërcënon Jordaninë dhe Turqinë, ndërkohë që Iraku praktikisht është

ndarë në tre shtete – një shiit, një sunit dhe një kurd. Në mesin e këtij kaosi, një formë veçanërisht e ligë e Islamit radikal sunit, Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë, ka pushtuar pjesë të mëdha të territorit në Siri dhe në Irak. Tani Jemeni ka shpërt-hyer në një tjetër luftë civile, e cila ka tërhequr drejt vetes forca nga i gjithë rajoni. Secili konflikt ka shumë shkaqe lokale – duke përfshirë rivalitetet fisnore komplekse dhe një luftë për naftën – por në themel të të gjithë këtyre është Loja e re e Madhe për dominim mes sunitëve dhe shiitëve. Shteti më i madh shiit, Irani, po e përhap ndikimin e tij duke financuar dhe armatosur militantët në të gjithë rajonin, ndërkohë që shteti më i madh sunit, Arabia Saudite, po i kundërvihet tashmë duke organizuar një forcë të përbashkët mbrojtjeje të shteteve arabe prej 40 mijë trupash elitë nga shtetet sunitë. “Që nga krijimi i Izraelit në vitin 1948, problemi arabo-izraelit ka qenë pothuajse sinonim me problemin e Lindjes së Mesme”, thotë politologu Michael Gunter. Por tani, “ndarja mes shiitëve dhe sunitëve është katalizatori kryesor që shtyn ngjarjet”.

Përse rivalitetet po ziejnë pikërisht tani?

Ky rivalitet ka nxitur konflikte dhe represion që nga fillimet e Islamit në shekullin 7, por në vitin 2003 ai u shndërrua në një zjarr të madh. Ishte viti kur SHBA rrëzoi regjimin e dominuar nga sunitët të Sadam Huseinit në Irak. Huseini kishte shtypur brutalisht për një kohë të gjatë shumicën shiite, dhe rënia e tij e ktheu përmbys këtë dinamikë të pushtetit. Qeveria e re e dominuar nga shiitët, me kryeministër Nuri al Malikin i marginalizoi sunitët e Irakut, duke u mohuar atyre një zë real në qeverinë e re kombëtare. Sunitët u rebeluan dhe al Kaeda bashkë me grupe të tjerë ekstremistë sunitë u bashkuan në përpjekjen për të përçarë Irakun; në luftën e përgjakshme që pasoi, si sunitët, ashtu edhe shiitët kryen masakra të shumta që sollën vdekjen e mijëra vetëve dhe thelluan armiqësinë mes dy sekteve. Shiitët persë të Iranit e shfrytëzuan këtë shans për të bërë aleancë me shiitët në jug të Irakut dhe fituan influencë në rajon. Të gjithë këto ngjarje shërbyen si një leksion i fuqishëm për fqinjët arabë të Irakut?

Cfarë mësuan ata?

Ata panë se edhe diktatorët më të frikshëm mund të rrëzohen nga pushteti. Duke filluar nga viti 2010, kryengritjet e Pranverës Arabe rrëzuan diktatorët në Tunizi, Libi dhe Egjipt, dhe ndihmuan për të ndezur më shumë luftën në Siri. Fatkeqësisht, këto revolucione nuk sollën demokraci dhe liri, por kaos, represion si edhe rritje të ndikimit të Iranit.

Cila është axhenda e Iranit?

Që nga Revolucioni Islamik i vitit 1979 që e transformoi Iranin në një teokraci shiite, ajatollahët janë përpjekur që të forcojnë pakicat shiite në botën arabe. Shiitët përbëjnë vetëm 15% të myslimanëve në mbarë botën, por ata janë shumicë në rajonet e pasur me naftë të Iranit dhe Irakut dhe kanë pakica të rëndësishme në Arabinë Saudite, Liban dhe Jemen. Irani është shndërruar në një partner de facto të qeverisë irakene me shumicë shiite, duke stërvitur 100 mijë luftëtarë shiitë që të mbrohen ndaj ISIS-it dhe kryengritësve sunitë. Irani po fut hundët edhe në Siri, duke ofruar mbështetje për regjimin e Bashar al Asadit, i cili është alavit, një nëndegë e sektit shiit. Dhe tani Irani ka futur hundët edhe në oborrin e pasëm të Arabisë Saudite, në Jemen, duke ofruar financime dhe mbështetje për hutitët jemenas, të cilët janë Zaidë, një tjetër nëndegë shiite. Të alarmuar prej përparimit të Iranit, sauditët ndërhyjnë javën e kaluar në luftën civile në Jemen, duke bombarduar pozicionet e hutitëve dhe grumbulluar 150 mijë trupa në kufi. “Ky është shembulli i parë ku sauditët kundërpërgjigjen fizikisht ndaj një kryengritjeje shiite, e si pasojë edhe kundër Iranit”, thotë John Jenkins, drejtor ekzekutiv i Institutit Ndërkombëtar për Studime Strategjike – Lindja e Mesme.

Kë po mbështet SHBA?

Varet nga vendi. Arabia Saudite ka qenë një aleat i rëndësishëm i Amerikës prej një kohe të gjatë, dhe në Siri, SHBA dhe sauditët janë në të njëjtën anë, duke

ofruar ndihmë për sunitët që rebelohen kundër Asadit. Por në Irak, SHBA e gjen veten aleate të heshtur të Iranit, pasi të dy mbështesin regjimin iraken në luftën kundër ISIS. Sauditët dhe sunitë të tjerë janë thellësisht të shqetësuar prej afritit të administratës Obama me Iranin, sidomos nëse marrëveshja bërthamore do të sillte një heqje të sanksioneve. “Shumë vende të Gjirit ndihen se po lihen pas dore”, thotë Mishaal A Gergavi, një komentator në Emiratet e Bashkuara Arabe. Mbreti saudit Salman u takua kohët e fundit me presidentët e Egjiptit dhe Turqisë, dy shtetet sunitë më të fortë ushtarakisht, për të diskutuar bashkimin kundër rrezikut iranian. Loja e Madhe, me sa duket, sapo ka nisur – dhe vite të tërë kaosi dhe konfliktesh të dhunshëm tashmë duken të pashmangshëm. “Në shekullin 20, secili shtet kishte vendin e tij në skenë”, tha një ekspert i rajonit që punon në Universitetin e Tel Avivit. “Tani i kemi hyrë një udhëtimi drejt një kapitulli të panjohur në Lindjen e Mesme”. /THE WEEK/



Detyrimi për të thyer heshtjen

NGA TONI MORRISON

Diktatorët dhe tiranët, përurojnë përherë mbretërinë dhe ushqejnë pushtetin e tyre, me shkatërrimin e qëllimshëm dhe të llogaritur të artit: censurën dhe djegien e librave që nuk janë në përputhje me linjën zyrtare, përndjekjen dhe burgosjen e piktorëve, gazetarëve, poetëve, dramaturgëve, romancierëve dhe filozofëve. Ky është hapi i parë i një despoti, që në aktet e tij instiktive dhe të kobshme, tregon jo thjesht ligësinë, por edhe aftësinë e perceptimit. Këta tiranë e dinë shumë mirë se strategjia e tyre e depresionit do t'u mundësojë instrumenteve reale të pushtetit shtypës, të zhvillohen me tej. Plani i tyre është i thjeshtë

Para se t'i jepja hollësi të tjera, ai më ndërpret duke thirrur: "Jo! Jo jo! Është pikërisht ky momenti, kur një artist duhet të përveshë mëngët. Jo kur çdo gjë shkon mirë, por në kohërat e frikës. Kjo është detyra jonë!"

U ndjeva budallaqe për pjesën tjetër të mëngjesit, veçanërisht kur mendova për artistët që i bënë veprat e tyre brenda në gulagët mizorë, qelitë e burgjeve, shtrërit e spitaleve; që e bënë punën e tyre ndërsa ishin të përndjekur, në mërgim apo të përqeshur. Mendova edhe për ata që ishin ekzekutuar.

Lista përfshin shekuj të tërë, dhe jo vetëm atë të fundit. Është tepër e gjatë. Sa

për të përmendur disa prej tyre Pol Robeson, Primo Levi, Ai Veivei, Oskar Uajlld, Pablo Pikaso, Deshiel Hamet, Uole Sojinka, Fjodor Dostojevski, Aleksandër Solzhenicin, Lilian Helman, Salman Rushdi, Herta Myler, Uollter Benxhamin. Nëse do të bëja një listë më të saktë, duhet të përmendja me qindra emra.

Diktatorët dhe tiranët, përurojnë përherë mbretërinë dhe ushqejnë pushtetin e tyre, me shkatërrimin e qëllimshëm dhe të llogaritur të artit: censurën dhe djegien e librave që nuk janë në përputhje me linjën zyrtare, përndjekjen dhe burgosjen e piktorëve, gazetarëve, poetëve, dramaturgëve, romancierëve dhe filozofëve. Ky është hapi i parë i një despoti, që në aktet e tij instiktive dhe të kobshme, tregon jo thjesht ligësinë, por edhe aftësinë e perceptimit.

Këta tiranë e dinë shumë mirë se strategjia e tyre e depresionit do t'u mundësojë instrumenteve reale të pushtetit shtypës, të zhvillohen me tej. Plani i tyre është i thjeshtë:

1. Zgjedhja e një armiku të dobishëm – një “Tjetri” – për ta shndërruar inatin në konflikt e deri në luftë.
2. Kufizimi ose fshirja e imagjinatës që ofron art, dhe madje edhe mendimin kritik të studiuesve dhe gazetarëve.
3. Hutimi përmes lojërave, ëndrrave dhe temave mbi superioritetin fetar ose krenarisë përbuzëse kombëtare, që fshehin në brendinë e të shkuarës së tyre, dhimbje dhe poshtërim.

Në këtë botë bashkëkohore të protestave të dhunshme, luftërave, kërkesave për bukë dhe paqe, ku qytete të tëra shpërngulen me nxitim në shkretëtirë, për t'u dhënë strehë popullsisë të dëbuara, braktisura, frikësuar, që ikin për jetën e tyre dhe jetën e fëmijëve, çfarë duhet të bëjmë ne, të ashtuquajturit të civilizuar?

Zgjidhjet anojnë nga ndërhyrja ushtarake dhe dilema: vrasje apo burgosje. Çdo veprim tjetër, nën këtë klimë politike të degraduar, shihet si një shenjë dobësie. Natyrshëm të vjen të pyesësh pse të qënit “i dobët” është bërë një mëkat ekstrem, i pafalshëm? A mos ndoshta sepse jemi bërë një komb aq i trembur nga të tjerët, nga vetvetja dhe qytetarët e vet, sa që kemi dështuar të njohim dobësinë autentike, poshtërsinë në insistimin për të kryer kudo ndërhyrje të armatosura?

Sa e pjekur, burrërore është të qëllosh ndaj mjekëve që praktikojnë abortin, fëmijëve që shkojnë në shkollë, kalimtarëve, adoleshentëve zezakë që ia mbathin me vrap? Sa e fortë, e fuqishme është ndjesia e të paturit një armë vrasëse në xhepin tuaj, në brez, apo në kroskotin e makinës? Sa autoritare është të kërcënosh me luftë në politikën e jashtme thjesht për forcë zakoni, frikë të trilluar apo ego kombëtare? Dhe sa patetike është? Patetike, sepse ne s'mund të dimë, në ndonjë skutë të ndërjegjes tonë, që burimi dhe arsyeja e agresivitetit tonë të ngulitur nuk është vetëm frika.

Është ndërkaq edhe paraja: stimuli i përfitimit të industrisë së armatimit, mbështetja financiare e kompleksit ushtarako-industrial, kundër të cilit na paralajmëroi dikur Ajzenhaueri. Të përdorësh forcën është e lehtë, kur qytetarët janë kryesisht të pakënaqur, kur provojnë ndjesinë e pafuqisë, të cilën dhuna mund t'ua lehtësojë. Dhe kur debati politik, prishet nga një paarsyeshmëri dhe një urrejtje aq e thellë, sa fyerjet vulgare duken normale dhe mungesa e afeksionit mbretëron.

Debatet tona, në shumicën e rasteve, do të degjeneronin edhe në oborrin e një çerdheje: fyerjet, shuplakat verbale, thashethemet, të qeshurat, të gjitha së bashku, tekta lisharëset e mirëqeverisjes mbeten bosh. Për pjesën dërmuese të 5 shekujve të fundit, Afrika është parë si një vend i varfër, mjaft i varfër, pavarësisht se është jashtëzakonisht i pasur me naftë, ar, diamante, metale të çmuara dhe kështu me radhë. Por duke qenë se këto pasuri, në pjesën më të madhe nuk i përkasin njerëzve që jetojnë atje përherë, kontinenti ka mbetur në mendjet e Perëndimit, si i denjë për përbuzje dhe natyrisht, për t'u plaçkitur.

Ndonjëherë, harrojmë se kolonializmi ishte dhe është luftë, një luftë për të kontrolluar dhe zotëruar burimet e një vendi tjetër, që do të thotë para. Mundemi

gjithashtu të mashtrujmë veten, dhe mendojmë se përpjekjet tona për “civilizuar” ose “paqësuar”, vendet e tjera, nuk kanë të bëjnë me paratë. Skllavëria ka qenë gjithmonë një çështje parash: krah i lirë pune që prodhon para, për pronarët dhe industrinë. Punëtorët e varfër dhe të papunët e ditëve tona, janë si pasuritë e fjetura të “Afrikës më të errët koloniale”, të ekspozuar ndaj vjedhjes së pagave dhe pasurisë, të zotëruara nga korporatat e mëdha kancerogjene, që mbytin zërat disidentë.

Asnjë nga këto dukuri, nuk të lë të parashikosh një të ardhme inkurajuese. Megjithatë mua me kujtohet britma e mikut tim atë ditë pas krishtlindjeve: Jo! Është pikërisht ky momenti, kur një artist duhet të përveshë mëngët. Nuk ka kohë për dëshpërim, vetëngushëllim, nuk ka vend për frikë. Ne flasim, shkruajmë, bëjmë gjuhë. Është kjo mënyra sesi qytetërimi shëron. E di se bota është plagosur dhe përgjakur, dhe nëse është e rëndësishme të mos e injorosh dhimbjen e saj, është gjithashtu thelbësore të mos i jepesh ligësisë së saj. Sikurse dështimi, edhe kaosi përmban informacione, që mund të çojnë drejt njohjes, dhe madje edhe urtësisë. Njësoj si arti. /“The Nation”

“Konsensusi Lagarde” / Moises Naim në një bisedë me Drejtoren

NGA MOISES NAIM

Bota është rritur edhe me masat e shtrëngimit, por duhen më shumë vende pune. Dhe gra në komandë. Drejtorja e FMN-së analizon emergjencat globale, që nga kriza deri tek reformat. “Kemi ndryshuar sistemin, kontribuesit nuk duhet të paguajnë më gabimet e financës. Dhe tani qeveritë kanë instrumentat për një zhvillim të qëndrueshëm”

Në vitet nëntëdhjetë, ishte në modë “Konsensusi i Uashingtonit”, bashkë me opinionet e mendimtarëve të ekonomisë si dhe funksionarëve të lartë me qendër në Uashington, sidomos ata të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore dhe Departamentit të Thesarit të qeverisë amerikane. “Konsensusi i Uashingtonit” ilustronte masat që qeveritë duhej të ndërmerrnin për të garantuar rritje ekonomike dhe prosperitet. Shumë vende e përshtatën formulën, ose më e pakta

shpallën qëllimin e tyre për të ndjekur recetën e saj: hapje për tregtinë dhe investimet, maturi në menaxhimin e financave publike, privatizime etj. Më pas erdhën krizat financiare: Meksika, Rusia, Brazili, Tailanda, dhe shumë të tjerë. “Konsensusi i Uashingtonit” përfundoi në bangën e të akuzuarve dhe politikanët që në fillim i thurnin himne, tani e vinin në shënjestër.

Ndërkohë që përgatitesha për intervistën me Christine Lagarde, ish Ministren e Financave të Francës, e cila që prej vitit 2011 është në krye të FMN-së, u kujtova që ishte shfaqur një tjetër konsensus, jo i lidhur me një tërësi specifike teorish ekonomike, por me atë vetë si person: mund ta quajmë “Konsensusi Lagarde”. Emri i saj rishfaqet vazhdimisht në të gjithë listat e personave më të pushtetshëm të botës, dhe shpesh herë përmendet bashkë me Angela Merkelin dhe Janet Yellen, guvernatoren e Bankës Qendrore të SHBA (FED), si një prej tre grave më të pushtetshme të planetit. E takova Christine Lagarde për një bisedë të gjatë në zyrën e saj, në selinë e FMN-së në Uashington. Me veshjen e saj të kuqe, dhe vathët me të njëjtën ngjyrë, është shumë elegante. I lexoj mbiemrat që sakonisht shoqërojnë emrin e saj dhe e pyes nëse është dakord me këtë Konsensusin Lagarde. “Nuk jam shumë e sigurtë për mbiemrin ‘ambicioze’”, nxiton të përgjigjet. “Epo, shikoni se ku ndodheni”, i them, duke i kujtuar më pas, por pa i përmendur, se me çfarë energjie u ka bërë presion vendeve të ndryshëm, që nga Kina në Brazil, që nga Rusia në Japoni, për të patur votat që i duheshin për t’u emëruar Drejtore e Përgjithshme e FMN. “Nëse jam inteligjente apo tërheqëse, kjo u takon të tjerëve ta thonë, por nuk jam dakord me historinë e ambicies, sepse e gjej të pabazë”, këmbëngul ajo. Detyrat me pushtet kanë qenë një konstante në karrierën e saj, por thotë se nuk ndihet kaq e pushtetshme. “Do të doja të isha, sepse nëse do të isha, atëherë me siguri do të mundesha të reduktoja papunësinë, të krijoja kushte për rritje ekonomike, të sillja pakëz buonsens në sallat ku ka shumë testosteron dhe shumë arrogancë... Këto janë gjëra që do të doja të bëja, por nuk mundem”.

EKONOMIA GLOBALE

Bota ka hyrë në një fazë të gjatë rritjeje ekonomike të ngadaltë, ajo që ekonomistët e quajnë “stanjacioni shekullor”? Christine Lagarde thotë se për të përshkruar situatën aktuale preferon të përdorë shprehjen “mediokriteti i ri”, dhe shpjegon se rritja ekonomike botërore në dy vitet e fundit, dhe sërish këtë vit, ka qenë mesatarisht 3.5%, praktikisht e njëjta normë mesatare me të cilën është rritur ekonomia botërore në dy dekadat e fundit.

Me fjalë të tjera, situata aktuale, nuk është kaq e ndryshme nga njëzetë vitet e fundit. Ajo që ka ndryshuar, vëren ajo me shqetësim, është natyra e rritjes ekonomike. “Nuk po krijon vendet e punës të nevojshëm, dhe krijimi i vendeve të punës është i shpërndarë në një mënyrë që nuk u përgjigjet nevojave. Po kështu, nuk po i jep shtytjen e mjaftueshme produktivitetit, dhe çuditërisht tregjet në zhvillim, që kanë potencialin për t’u rritur me një ritëm më të shpejtë, nuk po e bëjnë”.

Kur e pyes nëse kjo rritje e pamjaftueshme ka të bëjë me programet e kursimit që janë përshtatur në shumë vende pas vitit 2008, ajo përgjigjet se vënia përballë e masave të kursimit dhe rritjes ekonomike është një debat fals. “Të dyja këto nuk janë të papajtueshme. Mund të kesh në të njëjtën kohë rreptësi në menaxhimin e buxhetit dhe një rritje të qëndrueshme”.

Thomas Piketty, ekonomisti i famshëm francez, pohon se pabarazia ekonomike në rritje shkaktohet nga forca që kanë rrënjë të thella në sistemin kapitalist. A jeni dakord me të? Christine Lagarde shmang diskutimin e drejtpërdrejtë të tezës së Pikettyt dhe preferon të thotë: “Unë jam një nga ato që mendojnë se sistemi kapitalist i lë hapësirë të mjaftueshme inovacionit dhe që i kushtojnë shumë rëndësi forcave të tregut, por gjithmonë brenda një konteksti normativ që u ofron qeverive instrumentat për t’iu kundërvënë pabarazisë”. Teknologjia, tregtia ndërkombëtare, sistemi financiar dhe politikat publike përmenden së bashku si faktorët parë-

sorë në bazë të pabarazisë. Ju kë do të vendosnit në krye të listës? “Teknologjinë”, përgjigjet Lagarde, “por edhe financën, e cila përqëndron burime të mëdhenj mbi një grup të ngushtë. Dhe do të shtoja si faktor edhe kulturën, sidomos kur kjo kufizon shanset për gratë. Dhe natyrisht, korrupsionin”.

E shqetëson fakti që pesha, kostot e krizës financiare kanë rënë në mënyrë të shpërpjestuar mbi shpatullat e të varfërve dhe klasës së mesme, dhe shumë më pak mbi bankierët dhe financierët përgjegjës për shumë prej vendimeve që krijuan problemin? “Po, më shqetëson shumë”, përgjigjet Lagarde, “dhe në fakt jemi të angazhuar për ta ndryshuar situatën. Në fillim, kur një bankë përfundonte në telashe dhe duhej të shpëtohej, kjo bëhej me paratë e taksapaguesve. Tani kemi krijuar një sistem që e shkarkon barrën e shpëtimit mbi aksionistët e institucioneve financiarë që përfundojnë në telashe”. /Bota.al

Eshtë më i sigurtë tani sistemi financiar? “Po: qeveritë kanë tashmë bazat ligjore, mundësinë dhe autoritetin për të vepruar në mënyrë shumë më efikase”. A e shqetëson Lagarden përqëndrimi i lartë i veprimtarive financiare në pak institucione të mëdhenj? “Po, për dy arsye. Kur isha një avokate e re në moshë, kisha studiuar të drejtën e konkurrencës dhe kisha mësuar se përqëndrimi kufizon konkurrencën, dhe që kjo është një gjë e keqe. Shqetësimi im i dytë, pasi kam mbuluar disa detyra menaxheriale, është që organizatat shumë të mëdha dhe komplekse bëhen shumë të vështira për t’u menaxhuar, dhe bëhet shumë më e vështirë për t’i detyruar që të japin llogari për punën e tyre”.

PER GREQINE

Drejtorja e Përgjithshme e FMN është kritikuar më parë pasi ka qenë shumë “e butë” dhe tani se është “shumë e fortë” me qeverinë greke. Për shembull, Paolo Nogueira Batista, anëtari brazilian i bordit të FMN, ka thënë se “në rastin e Greqisë, rregullat e FMN-së janë shkelur për hir të nevojave të eurozonës. Kjo e ka dëmtuar rëndë besueshmërinë e institucionit”. Vështrimi i Christine Lagarde bëhet i ashpër, ajo nuk është aspak dakord: “Deklaratat e këtij zotërisë janë të pasakta. Janë shumë të pjesshme dhe nuk janë të bazuara mbi fakte... Për shembull, kemi kryer një studim mbi rregullimin e financave publike që kërkohen nga Fondi në vende të ndryshëm dhe kemi arritur në përfundimin se përpjekja që duhet të bëjnë europianët është më e madhe, për nga vëllimi dhe natyra, se sa ajo që u kërkohet për shembull, vendeve të Lindjes së Mesme si Jordania, Tunizia dhe Maroku”.

Christine Lagarde sapo është takuar me Yannis Varoufakis, ministri i EKonomisë i Greqisë, i cili pas takimit me të u ka thënë gazetarëve se “Greqia ka ndërmend të përballojë të gjithë borxhet e saj, me të gjithë kredidhënësit, gjithmonë”. “Ju besoni?” e pyes.

“Unë i besoj vetëm asaj që më ka thënë mua. Dhe më ka thënë se Greqia do të respektojë pagimin e borxheve afati i të cilëve po skadon”.

Po sigurisht, këmbëngul unë, ju duhet të keni një ide edhe për sa i përket të ardhmes jo të afërt. Ajo i rrëshket me zhdërvjelltësi pyetjes duke shmangur vërtetimin e premtimit të kryeministrit grek. Megjithatë, pranon se është e shqetësuar për perspektivën afatmesme të ekonomisë greke dhe thotë se mbetet ende shumë punë për t’u bërë, dhe që për ta bërë do të ketë nevojë për një sasi të madhe fryme bashkëpunimi dhe vullneti. “Dhe nga ana jonë ka me bollëk”, thotë.

EUROPA

A ka një defekt strukturor projekti evropian? A mundet një kontinent, me një monedhë të përbashkët që e ndajnë shtete me ekonomi ende shumë të fragmentuara, me normativa të ndryshme dhe secila me politikën e veta të buxhetit, të jetë e qëndrueshme? “Ju përshkruani të kaluarën”, replikon me forcë Christine Lagarde. “Që kur ka shpërthyer kriza financiare, Europa ka bërë hapa të mëdhenj përpara dhe shumë prej problemeve që ju përmendni janë përballuar, dhe rezultati është që sot, projekti evropian është më i fortë se kurrë”.

Mund të jetë edhe kështu, i them, por nuk mund të mohojmë se shumë europianë, duke lexuar një deklaratë të tillë, do të mendojnë: “Po në çfarë bote jeton?” Shumë janë të papunë, rrjetet e sigurimeve shoqërore janë reduktuar apo janë në rrezik, e ardhmja e bijve të tyre nuk është rozë, pabarazia është në rritje, tensionet sociale po rriten. Si mund t’i kërkohet kësaj popullsie të zemëruar, të shqetësuar dhe të irrituar, që të jetë e kënaqur me reformat që ju përmendët? “Të gjitha këto i di. Po flisja për projektin europian, jo për hapat përpara. Ai projekt sot është më i fortë dhe më mirë i mbrojtur. A do të thotë kjo që kushtet për rritjen ekonomike dhe prosperitetin janë forcuar? Ende jo. Por është bërë shumë në fushën e monedhës së përbashkët dhe politikave buxhetore. Dhe ka ende shumë për të bërë sa u përket reformave strukturore, e në mënyrë të veçantë sa i përket investimeve në infrastruktura. Këto dy leva – reformat strukturore dhe investimet në infrastruktura – janë absolutisht të domosdoshme për të stimuluar rritjen ekonomike, por autoritetet nuk i kanë përdorur atëherë kur duhej”.

Po Gjermania? Në të kaluarën, Lagarde nuk e ka fshehur irritimin e saj kundrejt Angela Merkelit dhe hezitimit të saj për të vepruar me më shumë vendosmëri për të stimuluar ekonominë e kontinentit të vjetër. Ky hezitim, e pyes, është një element ideologjik i kancelares gjermane? Pas një pauze të gjatë reflektimi, drejtorja e FMN-së shpjegon se nuk është e sigurtë që bëhet fjalë për një ideologji, por më shumë një “mentalitet që është shumë i përhapur mes taksapaguesve gjermanë”. Më pas nis të rendisë avantazhet e shumtë që ka patur Gjermania nga Europa, që nga euro, tek liria më e madhe e lëvizjes së krahut të punës, si dhe shtytjes së këtyre faktorëve i kanë dhënë ekonomisë së saj të bazuar në eksportet. Nxiton të theksojë se gjërat po ndryshojnë në një drejtim që atë e kënaq: pagat në Gjermani janë rritur dhe kjo do të thotë që kostoja e punës e eksporteve gjermane do të jetë më shumë në linjë me atë të pjesës tjetër të Europës. Ka mendim pozitiv edhe për faktin që Gjermania po lançon programe ambiciozë investimesh në infrastrukturë. Investimet publike në Gjermani, deri në këtë moment, kanë qenë dukshëm më të ulët se sa në pjesën tjetër të Europës.

CHRISTINE LAGARDE, BURRAT DHE GRATE

Drejtorja e FMN ka folur në mënyrë eksplicite edhe për nevojën për më shumë gra në pozicione me pushtet, si dhe në përgjithësi për angazhimin për krijimin e më shumë shanseve për seksin e dobët. Ka shprehur në mënyrë eksplicite edhe zhgënjimin e saj nga fakti që të 24 anëtarët e bordit të FMN (përveç njëres) janë burra. “Nuk mund të bëj asgjë, duke qenë se janë emëruar nga qeveritë respektive, por jam e lumtur që mes funksionarëve të nivelit më të lartë të organizatës tani ka shumë gra”, shpjegon.

Për Christine Lagarde, emërimi i grave në pozicione me përgjegjësi është një çështje barazie. Është sinqerisht e bindur se normalisht gratë arrijnë të menaxhojnë më mirë pushtetin se sa burrat. Dhe nuk ka hezitua ta thotë shumë herë publikisht. Ka pohuar gjithashtu se meshkujt i pengon shpesh herë një tepri arrogance dhe testosteronësh.

A nuk janë pohime seksiste, e pyes. “Jo, është e vërteta”, përgjigjet aty për aty. “Është një gjë që e kam parë personalisht gjatë jetës sime profesionale, si avokate, si menaxhere e një institucioni të rëndësishëm, si ministre e EKonomisë, apo si drejtore e përgjithshme e FMN. Dhe përpiqem të nxis të tjerët që të vënë në provë gratë dhe t’u japin shans të komandojnë, sepse janë në gjendje ta bëjnë, e ta bëjnë mirë madje”.

Christine Lagarde flet me forcë edhe për nevojën për të inkurajuar gratë që të kërkojnë me më shumë vendosmëri shanset për to, që të luftojnë për kushte më të mirë pune. “Ndonjëherë mendoj se ne gratë jemi armiku më i keq i vetvetes, në kuptimin që nuk kemi të njëjtin besim tek aftësitë tona, siç kanë shpesh burrat. Shpesh herë e nisim fjalinë me “më vjen keq t’ju them”, apo “a mund të them diçka”?

Për ta mbyllur, i kërkoj të më japë një mendim të sajën për faktin që tre drejtorët e përgjithshëm të FMN, në fillim ishin burra dhe europianë dhe të tre janë larguar para përfundimit të mandatit. Horst Kohler u largua për t'u bërë president i RFGJ, dhe më pas u detyrua të japë dorëheqjen; Rodrigo Rato u largua për një karrierë politike në Spanjë dhe tani ka probleme me drejtësinë; Dominique Strauss-Kahn u largua pa nder nga detyra, pasi u përfshi në një skandal seksual. "Ka një skemë që përsëritet?" e pyes. Christine Lagarde bën një pauzë, më sheh drejt e në sy e pastaj më thotë vendosmërisht: "Unë kam ndërmend ta mbyll mandatin tim". /The Atlantic/

Moises Naim është studiues pranë Carnegie Endowment for International Peace në Uashington. Libri i tij më i fundit është: "Fundi i pushtetit"

Greqia dhe Turqia kërcënojnë Perëndimin



Zgjedhjet flitoruse të Tsiprasit dhe politika e jashtme e Erdoganit tregojnë se si disa shtete tashmë i marrin shumë lehtë aleancat e vjetra Angelo Panebianco Prova teknike të rënies së Perëndimit. Në fazën e re të historisë botërore, ata që...

28/04/2015



Ne flasim gjuhën tuaj!

04 22 34 096
www.bankacredins.com

FOTO & VIDEO



Zemërimi i natyrës: momentet e tmerrshme të tërmetit në Nepal

28/04/2015

Zemërimi i natyrës: momentet e tmerrshme të tërmetit në



Pritja e shkabës...

28/04/2015

Fotografi te momenteve me te ulet te njezetimit SUDANI I JUGUT - Kevin Carter e shkëpi



Cifuti i fundit i Vinicas

28/04/2015

Kjo fotografi u gjet në albumin personal të një ushtari të Einsatzgruppen. Në pjesën e pasme

- Djakoshi që dorë të kalonte Murin
 - Ekzekutim në Liberi
 - EVEREST / Video e momentit tronditës kur orteku rrimben 17 alpinistë
- Me tepër në kete kategori →



Asnjëherë mos u kënaq me të zakonshmen.

- Banka që mund të trondisë sistemin ekonomik ndërkombëtar**
Nga Barthelemy Courmont Studjues në Institutin e
- 10 histori të pabesueshme të fshatarëve që u bënë mbretër**
James Jackson Për pjesën më të madhe të
- "Ungjilli i Marisë"**
I përkthyer kohët e fundit nga profesoria e fesë
- Jemi njerëz... për motive fetare**
Transmetimi i kulturës ka shënuar supremacinë e
- Napoleoni edhe autor tregimesh dashurie?**
Perandori ishte jo vetëm shkrimtar, por ai ishte

SHENDETI (SPONSORED)

- Spitali Amerikan dekorohet nga Presidenti i Republikës**
NGA: SPITALI AMERIKAN
- E rrallë! Nga Uells, 15 orë për t'u operuar në Spitalin Amerikan**